



Projekti i Shërbimeve Mjedisore  
Kontrata Nr. ESP-CS-QC-13.3

**Bashkia Gramsh – Ekonomia Pyjore Rove**

**Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave për periudhën 2021 - 2030**

Draft



Klient  
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit  
Koordinator i PSHM: ErionIstrefi

## Bashkia Gramsh – Ekonomia Pyjore Rove

### Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave për periudhën 2021 - 2030


Draft

Klient:	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Shqipëri
Përfitues:	Qeveria e Shqipërisë; Bashkia Gramsh
Projekti:	ZHVILLIMI I PLANEVE TË INTEGRUARA TË MBARËSHTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE NË BASHKINË GRAMSH, SHQIPËRI (Kontrata V)
Burimi i financimit:	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
Tipi i dokumentit:	Plani i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave të ekonomisë pyjore Rove
Nr. Kontrate:	ESP-CS-QC-13.3
Konsulent:	JV: ONF International (ONFI) & Lurimi shpk & Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale të Shqipërisë (FKPKKSH)
Date of report:	

Ekipi i konsulencës		
Ekspert kyç	Emër Mbiemër	Pozicioni
K-1	Julien Bouillie	Drejtuës i ekipit ndërkombëtar, ONFI
K-2	Jérôme Chabbert	Ekspert ndërkombëtar i kontrollit të cilësisë, ONF I
K-3	Elvin Toromani	Statisticien pyjesh, Lurimi shpk
K-4	Endri Bala, në bashkëpunim me Florjan Shima	Ekspert GIS, Lurimi shpk
K-5	Fran Gjoka	Agronom, ekspert kullotash, Lurimi shpk
K-6	Endri Bala, në bashkëpunim me Marenglen Biba	Ekspert IT, Lurimi shpk
K-7	Albora Kacani	Ekspert i angazhimit të palëve të interesuara, FKPKKSH
N-1	Cedric Lardeux	Ekspert ndërkombëtar i GIS, ONFI

**Kodi ALFIS:**

**Data e miratimit:**



## SHKURTESA

PMPK	Plan i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave
EP	Ekonomi Pyjore
PM	Plan Mbarështrimi
NjA	Njësi Administrative
SHPPK	Shoqata e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
FKPKKSH	Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale të Shqipërisë
ONFI	ONF International

## Përmbajtja

I.	Hyrje.....	9
I.1	Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave.....	9
I.2	Ecuria e punës dhe përgjegjësitë.....	9
I.3	Metodologjia e punës.....	12
I.4	Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK.....	14
II.	Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Rove .....	18
II.1	Informacioni i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore .....	18
II.2	Pronësia, administrimi dhe organizimi.....	19
II.3	Vendndodhja gjeografike dhe administrative .....	20
II.4	Konteksti i Bashkisë dhe EkonomisëPyjore .....	21
II.5	Historiku i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore.....	24
II.6	Situata demografike dhe socio-ekonomike.....	25
II.7	Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore.....	26
II.8	Gjuetia dhe peshkimi.....	27
II.9	Infrastruktura rekreative dhe didaktike .....	28
II.10	Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje .....	29
III.	Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave.....	30
III.1	Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave .....	30
III.1.1	Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet) .....	30
III.1.2	Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet) .....	31
III.1.3	Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela .....	31
IV.	Përshkrimi i stacionit .....	33
IV.1	Klima .....	33
IV.2	Topografia dhe morfologjia.....	34
IV.3	Gjeologjia.....	39
IV.4	Tokat.....	41
IV.5	Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë.....	43
IV.6	Erozioni nësipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore .....	44
IV.7	Rrëshqitjet e tokës.....	46
V.	Vegjetacioni dhe biodiversiteti.....	47
V.1	Brezat bio-klimatikë.....	47

V.2	Pyjet dhe kullotat .....	47
V.3	Tipet pyjore.....	49
V.4	Tipet e kullotave .....	50
V.5	Tipet e vegjetacionit potencial .....	50
V.6	Biodiversiteti.....	51
V.7	Prania e vlerave të larta mbrojtëse .....	52
V.8	Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin.....	53
V.9	Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore.....	53
VI.	Rrugët dhe infrastruktura.....	55
VI.1	Rrugët pyjore.....	55
VI.2	Struktura të tjera dhe përdorimet e tokës .....	56
VII.	Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat.....	57
VII.1	Analizimi i të dhënave për pyjet.....	57
VII.1.1	Analizimi i tipeve pyjore .....	57
VII.1.2	Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes.....	<a href="#">585857</a>
VII.1.3	Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimtarisë së stacionit .....	58
VII.2	Analizimi i të dhënave për kullotat.....	62
VII.2.1	Gjendja e kullotave .....	62
VII.2.2	Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullosore.....	64
VII.2.3	Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike .....	67
VII.2.4	Mbërritshmëria .....	71
VII.2.5	Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota.....	71
VIII.	Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave.....	72
VIII.1	Rezultati i inventarizimit në pyje .....	72
VIII.1.1	Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve .....	72
VIII.1.2	Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë .....	73
VIII.1.3	Struktura vertikale .....	74
VIII.1.4	Cilësia e lëndës drusore në këmbë.....	<a href="#">747475</a>
VIII.1.5	Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF) .....	76
VIII.1.6	Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit .....	<a href="#">767677</a>
VIII.2	Gjendja shëndetësore/fitosanitare .....	77
VIII.2.1	Drurët e tharë.....	<a href="#">777778</a>

VIII.2.2	Dëmtime të tjera .....	78
VIII.3	Prerjet e paligjshme.....	79
VIII.4	Rezultatet e inventarizimit të kullotave .....	80
VIII.4.1	Tipi dhe cilësia e kullotave.....	<del>808081</del>
VIII.4.2	Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit .....	<del>818182</del>
VIII.4.3	Numri aktual i blegtorisë .....	82
VIII.4.4	Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve .....	<del>828283</del>
VIII.4.5	Infrastruktura aktuale.....	<del>828283</del>
VIII.4.6	Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazëushqimore për bagëtitë.....	83
IX.	Objektivat e planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave .....	84
IX.1	Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë .....	84
IX.2	Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave.....	<del>858586</del>
IX.3	Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal .....	<del>858586</del>
IX.4	Objektivat kryesore të PMPK.....	<del>878788</del>
IX.5	Objektivat specifike për ekonominë pyjore .....	<del>888889</del>
IX.5.1	Objektivat specifike për përdorimin e tokës, funksionin dhe regjimin qeverisës .....	<del>888889</del>
IX.5.2	Objektivat specifike për tipet pyjore .....	<del>898990</del>
IX.5.3	Objektivat specifike silvikulturorë .....	<del>909091</del>
IX.5.4	Objektivat specifike për kullotat.....	<del>949495</del>
IX.5.5	Objektivat specifike për biodiversitetin.....	<del>959596</del>
IX.5.6	Objektivat specifike për gjendjen shëndetësore.....	<del>959597</del>
IX.5.7	Objektivat specifike për faunën e egër.....	<del>969697</del>
IX.5.8	Objektivat specifike për pyjet me funksion prodhues.....	<del>969697</del>
IX.5.9	Objektivat specifike për pyjet me funksion mbrojtës .....	<del>969698</del>
IX.5.10	Objektivat specifike për pyjet me funksion rekreativ .....	<del>979798</del>
IX.5.11	Objektivat specifike për pyjet me status mbrojtës.....	<del>979798</del>
X.	Masat e planifikimit / aktivitetet në kuadër të PMPK .....	<del>989899</del>
X.1	Mundësia vjetore e shfrytëzimit .....	<del>989899</del>
X.2	Prerjet silvikulturore vjetore .....	<del>9999100</del>
X.3	Planifikimi vjetor i masave.....	<del>101101102</del>
X.3.1	Masat në pyje .....	<del>101101102</del>
X.3.2	Masat në kullota .....	<del>102102103</del>

X.3.3	Masat në infrastrukturë dhe në sipërfaqet e degraduara, rekreative dhe didaktike <a href="#">103103104</a>	
X.4	Masat afatgjata.....	<a href="#">103103104</a>
X.4.1	Masat silvikulturore në pyjet trugishte .....	<a href="#">103103104</a>
X.4.2	Pyllëzimet dhe ripyllëzimet .....	<a href="#">103103104</a>
X.4.3	Masat e aplikuara në kullota .....	<a href="#">104104105</a>
X.4.4	Gjendja dhe masat në infrastrukturë .....	<a href="#">104104105</a>
X.4.5	Masat specifike për aktivitetet rekreative dhe didaktike.....	<a href="#">105105106</a>
XI.	Vlerësimi ekonomik .....	<a href="#">105105106</a>
XI.1	Vlerësimi i ndikimeve të masave të planifikuara mbi pyjet dhe kullotat .....	<a href="#">105105106</a>
XI.2	Planifikimi i të ardhurave / përfitimeve .....	<a href="#">105105107</a>
XI.3	Planifikimi i shpenzimeve .....	<a href="#">106106107</a>
XI.4	Analiza shpenzime – përfitim .....	<a href="#">106106107</a>
Shtojca 5:	Planifikimi vjetor i masave.....	<a href="#">150150152</a>
Shtojca 5:	Masat afatgjata silvikulturore dhe pyllëzimet .....	<a href="#">155155157</a>

## I. Hyrje

### I.1 Qëllimi dhe objektivat e Planit të Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Qëllimi kryesor i këtij Plani Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK) është të zhvillojë mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunktional të pyjeve dhe kullotave bashkiake brenda kufijve të Ekonomisë Pyjore (EP) Rove për periudhën 2021 - 2030, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike. Në këtë drejtim, ai synon të përcaktojë, përmes një qasjeje të integruar, pajtueshmërinë e ngushtë midis kufizimeve dhe mundësive për të vlerësuar burimet pyjore e kullotave dhe nevojat bashkiake dhe palëve të interesuara lokale për të maksimizuar përfitimet e tyre. Ndërkohë, qëllimi i ndjekur është krijimi i kushteve të përshtatshme për të rritur kapacitetin e stafit lokal dhe bashkiak për të zbatuar masat përmes një mirëkuptimi të ndërsjellë dhe duke rritur bashkërendimin dhe ndërveprimin.

Për të garantuar zbatim dhe interpretim efikas, plani aktual i mbarështrimit është shkruar në një mënyrë të qartë dhe konçize dhe konkluzionet kryesore theksohen me shkronja të zeza.

### I.2 Ecuria e punës dhe përgjegjësitë

Pasi konsulenca u caktua në 12 nëntor 2020 për një periudhë 6 mujore, ecuria e përgjithshme e punës u bë sipas kronologjisë së dhënë në faqen pasuese dhe plani është hartuar në bazë të udhëzuesit të vitit 2018.

Duhet theksuar se për shkak të krizës sanitare të Covid-19 dhe një afati kohor për t'u respektuar rigorozisht, siç shprehet nga përfaqësuesit e MTM dhe PSHM, konsulenca duhej të përballej me një ndryshim të sezonalitetit për kryerjen e inventarizimit në terren në sezonin e dimrit, krahasuar me periudhat e pranverës dhe verës që janë normale. Kjo nënkuptonte nga njëra anë një përshtatje të nevojshme të disa aspekteve të protokollit duke iu referuar udhëzimeve (për inventarin e kullotave), dhe nga ana tjetër nevojën për të zhvilluar parashikimin përmes planifikimit të disa opsioneve për mënyrën e mbledhjes së të dhënave, në varësi të shfaqjes së kushteve të papërshtatshme të motit.

Përgjegjësitë midis aktorëve (Bashkia Gramsh, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Organizata Jo-Qeveritare, Fakulteti i Shkencave të Pyjeve në Tiranë) u respektuan plotësisht siç përmendet në udhëzues dhe sipas kuadrit ligjor:

- Reforma Administrative dhe Ligji Nr. 115/2014;
- Ligji Nr. 9385/2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor" i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2016 "Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005";
- Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet";
- Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030 me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua përmirësimit të transferimit të kompetencave dhe vënies nënë praktikë të përgjegjësive të reja bashkiake në drejtim të qeverisjes së përgjithshme të pyjeve dhe kullotave, si dhe kontrollit të aktiviteteve dhe detyrave të kryera brenda kufijve të EP Rove.




### I.3 Metodologjia e punës

U zbatua një metodologji nëpërputhje të plotë me:

- Përshkrimet në udhëzues, kurdo që ishte e mundur për shkak të ndryshimit të imponuar të sezonalitetit për punimet e terrenit;
- Analizimin dhe zhvillimin kryer në raportin fillestar;
- Rekomandimet nga raporte të ndryshme të siguruar gjatë detyrës (tre raporte të brendshme për kontrollin e cilësisë dhe të progresit).

**Kushtet e motit dimëror në zonën malore të EP Rove dhe veçanërisht reshjet e dëborës deri në Prill, nuk lejuan mbledhjen e të dhënave përpara fundmuajt Prill 2021. Në të vërtetë, sipërfaqet provë nuk mund të ngriheshin plotësisht siç kërkohet nga udhëzuesi, ngulja e piketës në qendër dhe matjetpara shkrirjes së dëborës. Pavarësisht këtyre kushteve, u arrit që ky PMPK të hartohet dhe dorëzohet në kohë në fund të muajt Maj 2021.**



*Ilustrim i një grumbulli pyjor ahu nën dëborë herët në Prill në EP Rove dhe vështirësisë për mbledhjen e të dhënave (veçanërisht për nguljen e piketës në qendër të sipërfaqes provë)*

Për më tepër, metoda veprimit u caktua ndërmjet ekipit të konsorciumit dhe palëve të ndryshme të interesit, duke vënë theksin mbi aftësitë specifike të konsideruara si vendimtare për suksesin dhe cilësinë e PMPK. Kështu që, u krijua një bindje e qartë se vlera e shtuar e zhvillimit të PMPK Rove do të varet nga ecuria individuale e secilit aktivitet, si dhe nga ndërveprimet e frytshme ndërmjet të gjitha kompetencave të mbledhura bashkë. Prandaj, njëvëmendje e veçantë iu kushtua zhvillimit të një dialogu konstruktiv midis rezultateve nga inventarizimi në terren dhe rezultateve nga procesi i pjesëmarrjes.

**Në fakt është thelbësore që të lidhet analiza e burimeve pyjore dhe kullimore me vizionin lokal të shprehur përmes anketimit në terren dhe takimeve me palët e interesuara. Qëllimi është gjetja e ekuilibrit të duhur midis kapaciteteve të burimeve dhe pritshmërive të përdoruesve, në përputhje me rregulloret për njëmbarshtim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional.**

Analiza e palëve të ndryshme të interesit brenda Bashkisë Gramsh jepet më poshtë:

Palët e interesit	Interesi	Aktivitetet
<b>Banorët (me qëndrim të përhershëm, emigrantët dhe përdoruesit e pyjeve)</b>	-Mbrojtja dhe zhvillimi i pyjeve -Sigurimi i të drejtave ligjore për përdorimin e pyjeve dhe kullotave	-Prodhimi i druve të zjarrit, lëndës drusore për ndërtimin e shtëpive, mbledhja e frutave të pyllit & bimëve mjekësore dhe kullotja e bagëtive.
<b>Kryeplaku i fshatit dhe këshilli i fshatit</b>	-Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve të fshatit -Mbështetja e funksioneve të Bashkisë për mbarështrimin e pyjeve të fshatit	-Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me struktura të tjera përgjegjëse në kuadrin e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të PM -Ndërgjegjësimi i banorëve mbi rëndësinë dhe ruajtjen e pyjeve dhe orientimi i tyre për përdorimin e pyjeve në bazë të PM. -Sigurimi i informacionit mbi aktivitetet e paligjshme në pyje. -Bashkëpunimi me shoqatat e pyjeve dhe angazhimi i komunitetit në mbarështrimin e pyjeve. -Promovimi i zhvillimit të agropylltarisë.
<b>Vjelësit e produkteve pyjore jodrusore</b>	-Rritja e të ardhurave familjare	-Vjelja e frutave të pyllit dhe bimëve mjekësore.
<b>Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave</b>	-Rritja e pjesëmarrjes së banorëve për të siguruar mbarështrim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, pyjeve dhe kullotave të transferuara nën administrimin e qeverisjes vendore	- Pjesëmarrja në hartimin dhe zbatimin e planit të mbarështrimit dhe planeve operacionale. -Organizimi i aktiviteteve të ndërgjegjësimit të komunitetit. -Zbatimi i punimeve pyjore (pyllëzime, rrallime, pastrime, vepra anti-erozive, etj.). -Zbatimi i punimeve të përmirësimit të kullotave. -Hartimi dhe zbatimi i projekteve të ndryshme me mbështetje nga donatorë të ndryshëm.
<b>Bashkia</b>	-Mbarështrim i qëndrueshëm dhe shumëfunksional i pyjeve në nivel lokal. -Zhvillimi, ruajtja dhe administrimi i fondit pyjor	-Hartimi, zbatimi dhe kontrolli i mbarëvajtjes së PM. -Përgatitja e projekteve për investime për fondin pyjor të Bashkisë. -Monitorimi i punimeve të kryera në pyje, pavarësisht burimit të financimit. -Ofrimi i mbështetjes teknike dhe këshillimore për pronarët, përdoruesit dhe shoqatat e pyjeve.

	nëpronësi të Bashkisë.	-Bashkëpunimi me Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave dhe organizata të tjera të shoqërisë civile. -Garantimi i përfshirjes së komuniteteve lokale në administrimin dhe mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave.
<b>Bizneset e bazuara në prodhimet pyjore jodrusore</b>	-Fuqizimi i zinxhirit të vlerës së prodhimeve pyjore jodrusore	-Kultivimi dhe grumbullimi i bimëve të ndryshme dhe bimëve mjekësore. -Eksportimi i bimëve.
<b>Konçesionarët e shfrytëzimit të pyjeve</b>	<b>Te komunikohet me kompanine</b>	<b>Te komunikohet me kompanine</b>
<b>Organizata ndërkombëtare / donatorë (Fondacioni CNVP)</b>	-Mbështetja e familjeve rurale për rritjen e të ardhurave të tyre përmes kultivimit të bimëve mjekësore dhe prodhimeve të tjera pyjore jodrusore	-Mbështetje e drejtpërdrejtë me fidanë dhe asistencë teknike. -Lehtësimi i kontratave me grumbulluesit e bimëve. -Ndihma për futjen në treg.

Sipas parimit të transferimit të kompetencave dhe rritjes së ndërgjegjësimit midis aktorëve –si një zbritje e drejtpërdrejtë e ligjit shqiptar të rregullimit të pyjeve dhe qëllimeve të politikës – ky parim u zbatua për t'i dhënë informacione paraprake Kryetarit të Bashkisë së Gramshit, stafit të tij të pyjeve dhe kryetarëve të fshatrave përpara çdo aktiviteti të kryer brenda bashkisë, duke i sjellë të gjithë bashkë. Kjo bëri të mundur mbledhjen e mendimit të përfaqësuesve të Gramshit në lidhje me përdorimin e pronës së tyre, dëshirat e tyre për të zhvilluar trashëgiminë dhe mënyrën se si ata do ta administrojnë atë në të ardhmen. Kurset e rregullta, të cilat ofroheshin gjatë rrugës për palët e interesuara të Bashkisë, luajtën gjithashtu një rol aktiv për transferimin e njohurive.



Më në fund, siç ishte rënë dakord me klientin, ekspertët e konsorciumit ftuan rregullisht koordinatoren e PSHM, përfaqësuesit e MTM dhe AKP për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme, veçanërisht në takime për ndarjen e përvojave, kurse trajnimi, takime lokale të angazhimit të palëve të interesuara.

Kjo rezultoi në marrëdhënie të rregullta dhe të ngushta midis të gjithë aktorëve, ku vlen të theksohet një gadmishmëri dhe përfshirje vendimtare e Koordinatorit të PSHM-së dhe e Kryetarit të Bashkisë së Gramshit.

#### 1.4 Informacioni i përdorur në përgatitjen e PMPK

Krahas informacionit të mbledhur gjatë inventarizimit në terren dhe procesit pjesmarrës, informacioni specifik që ishte i domosdoshëm të sigurohej në nivelin e Bashkisë Gramsh në fillim të aktiviteteve ishte:


- Ndarjet parcelare dhe n/parcelare për EP Rovesipas kadastrës;
- Korrespondenca nga njësitë administrative të mëparshme deri në organizimin territorial aktual, pasi EP Rove aktuale është rezultat i ish njësisë administrative Rove dhe pjesërisht e njësisë administrative Kukur:
- PMPK imëparshëmi EP Kukurqë i kishte mbaruar afati (periudha 2008 – 2017) dhe EP Rove (periudha 1984 – 1993) me hartat dhe formularët e inventarizimit përkatës;
- Lista e përfaqësuesve të fshatrave për EP Rove.



*Ilustrim i EP Rove(burimi: ONF I)*

Lloji i të dhënave	Burimi	Komente
PMPK për Kukurin, periudha 2008 – 2017 PMPK për EP Rove, periudha 1984 - 1993	Bashkia Gramsh	PMPK u dorëzua së bashku me formularët përkatës të inventarizimit të pyjeve dhe kullotave
Kadastra, parcelat dhe n/parcelat	Nivel kombëtar dhe bashkiak	Mospërputhje midis sipërfaqes dhe mbulesës së vegjetacionit (VKM nr. 684, dt. 2.09.2020)
Njësitë administrative të mëparshme, situata administrative aktuale	Bashkia Gramsh	-
Lista e përdoruesve dhe shoqatave të pyjeve	Bashkia Gramsh	-
Lista e 97 fshatrave përgjatë bashkisë Gramsh me personat e kontaktit	MTM	5fshatra brenda kufijve të EP Rove
Ortofoto	Nivel kombëtar dhe bashkiak	Përditësuar në vitin 2015
Lidar	MTM	Dosja u dorëzua më dt. 25.02.2021

# Lidar map



Shembull se si janë përdorur të dhënat nga LIDAR për klasat e lartësive të drurëve nga 0 deri 40 m (burimi: ONF I)


Më pas, më dt. 19.03.2021, nga ana jonë u dërgua një kërkesë Bashkisë për të siguruar të dhënat e nevojshme për EP Rove, të cilat përmenden në udhëzues që nuk mund të gjendeshin nga burime të tjera:

- Të dhëna demografike dhe ekonomike;
- Aktivitete të lidhura me prodhime drusore dhe jodrusore nga pyjet dhe kullotat;
- Konçesione të mëparshme dhe në vazhdim për shfrytëzimin e pyjeve;
- I gjithë informacioni lidhur me kontratat e nënshkruara ndërmjet Bashkisë dhe çobenjve. Ky informacion është thelbësor, duke qenë se ndryshimi i sezonit të inventarizimit në terren nuk mundësoi mbledhjen e të dhënave të kërkuara, veçanërisht për koeficientin e shfrytëzimit të kullotave dhe kapacitetin mbajtës të tyre (si pasojë e mungesës së vegjetacionit barishtor në stinën e dimrit);
- Rrugët dhe infrastruktura pyjore;
- Të dhëna historike mbi zjarret në pyje dhe rreziqet natyrore (rrëshqitjet e tokës, përmbytjet, stuhitë, tharjet e drurëve);
- Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë;
- Prania e aktiviteteve edukative dhe didaktike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e aktiviteteve turistike lidhur me pyjet dhe kullotat;
- Prania e siteve me vlera të larta mbrojtjeje. Kjo përfshin rezervatet farore, habitatet e veçanta (liqene, pyje të brigjeve të lumenjve...), site të njohura për vlerat kulturore, peizazhe të mbrojtura.;
- Prania e aktiviteteve kërkimore në pyje dhe kullota.

## II. Përshkrim i përgjithshëm i bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore Rove

### II.1 Informacion i përgjithshëm rreth Bashkisë dhe ekonomisë pyjore

- Bashkia Gramsh;
- Ekonomia Pyjore Rove;
- Sipërfaqja e përgjithshme e njësisë administrative Rove: 3085.5ha;
- Sipërfaqja e përgjithshme e Ekonomisë Pyjore Rove, bazuar në VKM nr. 684, 2.02.2020: 2196 ha (burimi: GIS, i cili suposohet të jetë më i saktë se kadastra);
- Vlefshmëria e PMPK: 2021 – 2030 (10 vjet);
- Planet e mëparshme që u ka mbaruar afati:
  - ✓ PMPK për EP Kukur për 1075ha: vlefshmëria Qershor 2008 – Qershor 2017.
  - ✓ PMPK për EP Rove për 2234 ha: vlefshmëria 1984 – 1993.



Faqja e parë PMPK të mëparshëm që mbulon EP aktuale të Roves

## II.2 Pronësia, administrimi dhe organizimi

### *Pronësia dhe situata e përdoruesve në të shkuarën*

Gjatë periudhës 1900 – 1944, pyjet dhe kullotat ishin kryesisht pronë e pronarëve të mëdhenj dhe pjesa e mbetur, e banorëve të fshatrave. Pyjet dhe kullotat e fshatrave përdoreshin individualisht, duke respektuar kufijtë dhe traditat e vjetra, ndërkohë fshatarët mund të hynin në pyjet privatë për kullotje të bagëtive ose për lëndë drusore në këmbim të taksës ose punës që do duhet të kryenin. Për periudhën pasuese deri në vitin 1996, pyjet dhe kullotat administroheshin nga shteti dhe përdorimi i tyre ishte i përbashkët dhe i kushtojë interesave të shtetit. Planet e mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave hartoheshin përgjithësisht vetëm për funksionin prodhues të pyjeve (që nënkupton erozionin progresiv dhe braktisjen e mëtejshme të disa tokave joprodhuese) dhe vendimet merreshin pa u këshilluar paraprakisht me komunitetet lokale, të cilët filluan t’i konsideronin pyjet dhe kullotat si të largëta. Pas kësaj periudhe, politikat pyjore dhe kullorore filluan të nxisin përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje dhe zbatimin e PMPK-ve. **Kjo rezultoi në një proces decentralizimi, ku Qeveria e transferoi pronësinë mbi pyjet dhe kullotat dhe përgjegjësitë lidhur me to tek njësitë e qeverisjes vendore.**

Në lidhje me kuadrin ligjor, Ligji nr. 9385/2005 për “Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” i ndryshuar me Ligjin nr. 48/2016 “Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385”:


- Bashkia zhvillon strukturën e saj menaxhuese, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor brenda kufijve territorial administrativë (neni 7, paragrafi 3.1);
- Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve lokalë ndërmerret nga Bashkia (neni 23, paragrafi 1);
- Përgatitja e planit të mbarështrimit për pyjet dhe kullotat i ngarkohet stafit të Bashkisë (Ligji nr. 48/2016).

Por, **Bashkia Gramsh duhet të arrijëfuqi dhe mjete të plota mbi kontrollin që duhet të shoqërojë transferimin e pronësisë së pyjeve dhe përgjegjësitë lidhur me ta.** Kështu që, përdorimi i pyjeve dhe kullotave (shfrytëzimi i druve të zjarrit, kullotja, prodhimi i gjethit dhe bimëve mjekësore) duhet të planifikohet në lidhje me mbarështrimin, si edhe kontrollin e tyre brenda EP Rove.

### II.3 Vendndodhja gjeografike dhe administrative

Numri i parcelave dhe n/parcelave, si edhe ndarja e sipërfaqes në pyje, shkurre, kullota dhe inproduktive jepen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm (burimi VKM Nr. 684, datë 2.02.2020):



Numri i parcelave dhe n/parcelave	EP Rove
Tokë pyjorë	162
Tokë kullosore	34
Inproduktive	18
<b>Gjithsej</b>	<b>214</b>



## II.4 Konteksti i Bashkisë dhe Ekonomisë Pyjore

- Gramshi është një Bashki e Qarkut Elbasan në Shqipëri nëqëndrore. Bashkia u krijua me reformën e qeverisë të vitit 2015 nga bashkimi i qytetit Gramsh dhe ish komunave Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Pishaj, Poroçan, Skënderbegas, Sult dhe Tunjë, që tashmë janë njësi administrative. Selia e bashkisë është qyteti Gramsh dhe popullsia e përgjithshme është 24,231 banorë, sipas censurit të kryer në vitin 2011. Sipërfaqja e përgjithshme është 74, 229 ha. Një përmbledhje e sfidave kryesore dhe mundësive lidhur me territorin e përgjithshëm të Gramshit për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave jepet në këtë pjesë (seksion).
- Gjendja dhe qëndrueshmëria e pyjeve dhe kullotave në nivel Bashkie. Situata më poshtë tregohet sipas të dhënave të mbledhura më të fundit (*burimi: VKM nr. 684, dt. 2/02/2020*).

E gjithë Bashkia Gramsh		Pyll, kullotë dhe sipërfaqe inprodutive në pronësi të bashkisë	Sipërfaqe të tjera të Bashkisë
Tipet e tokës	Tokë pyjore	38 513 ha	20 293 ha
	Tokë kullimore	9 957 ha	
	Tokë inprodutive	5 466 ha	



- Lidhur me evolucionin historik dhe mbarështrimin aktual të pyjeve dhe kullotave dhe përdorimin e tokës në Bashkinë Gramsh, mungesa e administrimit të përgjithshëm, kontrollit dhe përvetësimit nga palët e interesuara lokale në të shkuarën (shih pjesën II.2) **ka rezultuar në një pakësim serioz të burimeve pyjore, si në sasi ashtu edhe në cilësi dhe në një përkeqësim të përgjithshëm të burimeve kullosores. Grumbujt pyjorë janë kryesisht të disbalancuar me pjesëmarrje të tepërt të moshave të reja dhe me kategori diametrike të vogla si pasojë e mbishfrytëzimit dhe prerjeve të paligjshme në dekadat e fundit.** Megjithatë, është e dallueshme që prerjet e paligjshme nga firmat e shfrytëzimit (përveç nevojës së komuniteteve lokale) janë ulur ndjeshëm që prej hyrjes në fuqi të moratoriumit të pyjeve në vitin 2016.

Mëkonkretisht, sipërfaqja e dushqeve ka qenë në degradim të vazhdueshëm për shkak të presionit të prerjeve, krasitjeve dhe kullotjes, çka nuk ka lejuar prodhimtë duhur të lendeve dhe ripërtëritje të mjaftueshme. Shkurret e përziera dhe të thjeshta janë pjesë integrale e formacioneve pyjore me një trend rritjeje në sipërfaqe; ato duket të jenë të degraduara dhe tëmbipërdorura nga trajtimi si kullota pa përdorim racional ose të qëndrueshëm dhe nga mos konsiderimi si grumbuj tranzitorë për t'u konvertuar në një prodhim më të vlefshëm (prodhime drusore dhe jodrusore). **Tokat në shumicën e pjesëve përfundimisht përballen me një erozion domethënës,** për shkak të humbjes së vegjetacionit barishtor, mbikullotjes dhe pengimit të ripërtëritjes (dhe ndonjëherë për shkak të lëvizjetëve vazhdueshme të bagëtive).

Duhet theksuar, që në këto rrethana, plani mëparshëm i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave nuk ka rezultuar në një përmirësim domethënës të këtyre çështjeve, ndonëse objektivat kryesore të këtij plani kishin theksuar përparësinë për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve të pyjeve, si psh. përmirësimin e rritjes vjetore dhe cilësisë së pyjeve duke rritur dendësinë dhe volumin e drurëve për njësi sipërfaqe. **Mos arritja e këtyre qëllimeve nënvizon domosdoshmërinë e një bashkërendimi dhe kontrolli më të mirë midis stafit pyjor të Bashkisë dhe aktorëve lokalë për zbatimin e PMPK në të ardhmen.**

- Lidhur me përdorimin e pyjeve dhe kullotave në 97 fshatrat brenda Bashkisë Gramsh, shumica e tyre vlerësohet t'i përdorin në mënyrë të përbashkët ose tradicionale (familje ose grupe familjesh), ndërsa shumë pak vlerësohet të kenë përdorim në mënyrë individuale ose private. Fshatrat drejtohen nga komisionet e fshatit, të cilat u panë individualisht për 48 fshatrat që bëjnë pjesë në pesë Ekonomitë Pyjore të përfshira në projekt (EP Gramsh-Vinë, Dushku i Bulçarit, Vidhan-Skënderbegas, Rove, Holtë-Lukovë).


Ekzistojnë dy shoqata të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave brenda Bashkisë, të cilat janë aktive në EP Gramsh-Vinë dhe Vidhan-Skënderbegas.


- Konteksti socio-demografik karakterizohet nga një migrim i shpejtë dhe intensiv nga zonat rurale më të largëta drejt zonave urbane.

- Tregu i lëndës drusore kryesisht përfaqësohet nga drutë e zjarrit dhe prodhime të tjera drusore (nga krasitjet ose rrallimet) që priten nga fshatarët për nevojat e tyre familjare, pasi moratoriumi për ndalimin e shfrytëzimit të pyjeve për qëllime të tjera industriale është në fuqi deri në vitin 2026. Prodhimi i druve të zjarrit, veçanërisht në formacionet e shkurreve nuk është menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme, pa ndjekur një radhë pune të përcaktuar për të ditur vendndodhjen e tyre në parcelë dhe kohën e kryerjes. Prodhime të tjera druri mund të përdoren nga fshatarët si materiale bazë ndërtimi për ruajtjen e zaireve për bagëtitë dhe si hunj për gardhe. Një kompani kryesore brenda Bashkisë Gramsh po operon për shfrytëzimin e pyjeve (përveç druve të zjarrit dhe prodhimeve të tjera

të drurit të siguruara drejtpërdrejt nga fshatarët për nevojat e tyre familjare), pasi koncesionet e miratuara para moratoriumit të pyjeve janë jashtë efektit ligjor të tij.

- **Prodhimet jodrusore** konsistojnë në pjesën më të madhe në prodhimin e gjethit për bagëtitë (pyjet e dushqeve dhe të ahut dhe shkurret e shkozës janë veçanërisht të shënjestruara edhe pse ka dhe lloje të tjera që përdoren), prodhimin e frutave nëpemtore apo në pyje (lidhur me gështenjen dhe lajthinë), prodhimin e mjaltit, bimë drunore dhe barishtore vilen dhe tregtohen për vlerat e tyre mjekësore (*Malus communis*, *Juniperus oxycedrus*, *Crataegus monogyna*, *Achillea millefolium*, *Papaver rhoeas*, *Capsella bursa-pastoris*, *Urtica dioica*).
- Brenda kufijve të Bashkisë Gramsh bëjnë pjesë disa Ekonomi Pyjore, ku për pesë prej tyre po hartohen njëkohësisht PMPKnga konsulenca e këtij projekti: Gramsh-Vinë, Dushku i Bulçarit, Vidhan Skënderbegas, Rove, Holtë-Lukovë. Hartat e mëposhtme i paraqisin këto Ekonomi Pyjore së bashku brenda kufijve të Bashkisë, në lidhje me situatën territoriale të tyre në përgjithësi dhe përdorimin kryesor të tokës.





## II.5 Historiku i mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave në Ekonominë Pyjore

Konsideratat historike të dhëna në pjesët e mësipërme në nivel të Bashkisë Gramsh janë të rëndësishme për EP Rove. Duke iu referuar PMPK-ve të mëparshme të EP Rove dhe Kukur, mund të jepet një përmbledhje e shkurtër e situatës dhe mbarështrimit për atë periudhë.

	(ish) EP Rove dhe Kukur që i korrespondojnë EP Rove aktuale
Pyje prodhues	69%
Pyje djerrë	5%
Kullota	11%
Toka bujqësore	15%
Toka inprodutive	69%

Objektivat e përgjithshëm të PMPK-ve të mëparshëm theksonin përparësinë për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve të pyjeve dhe kullotave, si psh. përmirësimin e rritjes vjetore dhe cilësisë duke siguruar ruajtjen e biodiversitetit dhe funksionet mbrojtëse (veçanërisht mbrojtjen ndaj erozionit). Funkzioni kryesor i tyre i kushtojë mbrojtjes së mjedisit dhe përmbushjes së nevojave të domosdoshme

të përdoruesve (lëndë drusore, kullotë për bagëtitë, fruta për ushqim) pa prodhim lënde drusore për shitje, gjë që fatkeqësisht duket që nuk është rasti.

Në këtë kuadër, kërkesapër lëndë drusore llogaritet mbi bazë të një mesatareje të nevojave vjetore prej 10 m<sup>3</sup> dru zjarri dhe 1.5 m<sup>3</sup> material drusor për familje. Si shembull, për të gjithë EP Kukur (2940 ha tokë pyjore), kjo mundësi korrespondonte me 26 450 m<sup>3</sup> dru zjarri në vit dhe 3780 m<sup>3</sup> material drusor në vit. Zbatimi i kësaj mundësie nxorri në pah nevojën për masa organizative nga Bashkia për një përdorim sa më racional dhe efikas të burimeve pyjore.

Sikurse përmendet në seksionin e mëparshëm, **ky plan mbarështrimi i pyjeve dhe kullotave nuk është kryer siç duhet plotësisht**. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave në EP Rove nuk mund të konsiderohet si rezultat i një mbarështrimi të qëndrueshëm dhe shumëfunksional, pasi presioni mbi burimet nuk mund t'i lejojë ata të ripërtërihen ose rimëkëmben në kushte të kënaqshme dhe po krijonjë erozion të tokës në rritje. Megjithatë, janë kryer disa pyllëzime dhe punime përmirësuese në pjesë të ekonomisë pyjore. Përveç kësaj, prerjet e paligjshme nga firmat e shfrytëzimit (përveç nevojave të komuniteteve lokale) janë ulur dukshëm që prej hyrjes në fuqi të moratoriumit të pyjeve në vitin 2016.

Formatted: Albanian


## II.6 Situata demografike dhe socio-ekonomike

Të dhënat që vijnë nga censusi, të konfirmuara në terren gjatë procesit pjesëmarrës dhe anketimit në terren, tregojnë që numri i banorëve të të gjithë fshatrave që gjenden brenda kufijve të EP Rove është rreth 1980, që përfaqësojnë një total prej 655 familjesh. EP Rove duket të jetë mesatarisht e populluar në krahasim me ekonomitë pyjore të tjera, për të cilat po hartohen PMPK.

**Karakteristika kryesore që duhet theksuar është tendenca e qartë për rënien e shpejtë demografike, e cila ka nisur që në vitin 1991 për secilën grup moshë, gjini dhe klasë shoqërore nëpërmjet migrimit nga fshatrat në zonat urbane.** Në disa zona të thella, kjo rënie shkon deri në pesë herë më pak banorë. **Prandaj, ky fenomen ka një ndikim madhor duke zvogëluar në mënyrë të ndjeshme presionin nga fshatrat mbi burimet pyjore dhe kullosore, ndonëse janë vërejtur shenja të presionit të lartë në disa zona në afërsi të fshatrave.**

Struktura demografike e popullsisë së fshatrave të EP Rove jepet hollësisht në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm (*burimi : sondazh i vitit 2021 para se të fillonte zhvillimi i PMPK*).

Fshati	Numri i familjeve	Popullsia e përgjithshme	Komision fshati(po/jo)	Përdorimi tradicional i pyjeve (përbashkët, familje, individual etj.)
Kukur	325	970	Po	Përdorim tradicional (sipas familjeve/përbashkët)
Gribë	175	550	Po	Përbashkët
Rmath	80	245	Po	Përbashkët
Vreshtas	75	215	Po	Përbashkët



Duhet përmendur që fshatrat Gribë, Kalaj, Rmath dhe Vreshtas nuk ndodhen në mënyrë rigoroze brenda kufijve të EP Rove, por shumë afër saj, pra EP është pjesë e përdorimit të tyre të zakonshëm.

## II.7 Tregtimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jodrusore

Tregtimi i prodhimeve drusore dhe jodrusore për EP Rove përgjithësisht është lidhur me përshkrimin e dhënë në pjesën II.4 në shkallë Bashkie.

Prodhimet drusore kryesisht përfaqësohen nga drutë e zjarrit dhe më rrallë nga prodhimet e tjera që lidhen me punimet pyjore (nga krasitjet apo rrallimet) të kryera nga fshatarët për nevojat e tyre. Përveç druve të zjarrit, çka përbën deri 85% të nevojave lokale, nga fshatarët mund të përdoren prodhime të tjera drusore, si material ndërtimi për ruajtjen e bazës ushqimore për bagëtitë dhe hunj gardhesh në tokat kullosore. **Rezultoni që tregtimi i prodhimeve drusore është i rrallë tek banorët.** Vlerësohet që tregtimi lidhur me shfrytëzimin e lëndës drusore për qëllim industrial funksionon disi, pavarësisht moratoriumit në fuqi, edhe pse praktika të tilla duket që kanë rënë viteve të fundit.

**Nuk ka një strukturë reale pyjore dhe asnjë mekanizim të punimeve në pyje dhe niveli i aftësive profesionale të punëtorëve lokalë është i ulët.** Megjithatë, punimet pyjore mund të jenë një perspektivë ekonomike në të ardhmen dhe banorët lokalë janë shprehur të interesuar për t'u përfshirë nëqoftëse u sigurohet trajnimi dhe punësimi. Por, situata aktuale është që prodhimi i druve të zjarrit për plotësimin e nevojave lokale përgjithësisht është i pakontrolluar dhe mund të kryhet në çdo parcelë dhe në çdo kohë, pa racionalizim dhe bashkërendim ndërmjet komuniteteve lokale dhe shërbimeve bashkiake. Materiali drusor për ndërtimet lidhur me bagëtitë (plevicat, gardhet) shfrytëzohet në grumbujt e mbetur të dushqeve dhe shkozës.

**Prodhimet jodrusore** gjithashtu përdoren më së shumti për nevojat lokale, me nivel të ulët tregtimi. Rasti është për prodhimin e gjethit për bagëtitë, që sigurohet nga pyjet e dushqeve dhe ahut, si edhe nga shkoza, të cilët janë subjekt i presionit të lartë të krasitjeve. Në disa toka pyjore dhe kullosore, por gjithashtu në hapësirat e ndërmjetme midis tokave bujqësore kultivohen disa lloje bimësh mjekësore

drunore dhe barishtore (*Malus communis*, *Castanea sativa*, *Juniperus oxycedrus*, *Crataegus monogyna*, *Achillea millefolium*, *Papaver rhoeas*, *Capsella bursa-pastoris*, *Urtica dioica*, *Rubus ideaus*), disa prej të cilave tregtohen dhe kanë ndikim pozitiv tek të ardhurat e banorëve. Mund të ndodhë edhe për disa prodhime të tjera në sasi të vogla: frutat e mbledhura në pyje ose pemtoret (gështenja, lajthi) agropjlltaria e zhvilluar krahas tokës bujqësore në afërsi.

Lidhur me blegtorinë, **Gramshi është një bashki me orientim blegtoralo-bujqësor, ku nga totali i të ardhurave, sektori i blegtorisë zë 60%**. Sipas të dhënave të siguruar nga bashkia për hartimin e PMPK-ve, aktiviteti blegtoral dhe bujqësor është rritur viteve të fundit në saje të rritjes së rendimenteve të mundësuar nga subvencionet qeveritare. Ka një interes në rritje për shtimin e numrit të krerëve të bagëtive, sipërfaqeve të mbjella me foragjere të ndryshme për mbarështimin e kafshëve dhe shfrytëzimin e kullotave verore.

Konkretisht, në Gramsh janë regjistruar në sistemin e informacionit blegtoral RUDA mbi 4760 fermerë blegtoralë. Për sa i përket numrit të blegtorisë që mbarështojnë, të dhënat e Bashkisë paraqesin për llojet: Gjedhë: 4636 krerë; të leshta: 25069 krerë; të dhirta: 13523 krerë; derra: 132 krerë; njëthundrakë: 2360 krerë; shpendë: 54810 krerë; bletë: 6777 koshere. Prodhimi i përgjithshëm vjetor nga blegtoria shkon 27285 ton qumësht dhe 3551 ton mish, i cili ndahet në: qumësht lope: 21279 ton; qumësht dele: 2223 ton; qumësht dhie: 3791 ton; mish gjedhi: 1647 ton; mish dele: 1065 ton; mish dhie: 624 ton. Për më tepër, prodhohet edhe 90 ton mjaltë në vit.

Kullotat verore dhe dimërore, të cilat përdoren nga blegtorët përmes lidhjes së kontratave me Drejtorinë e Pyjeve janë: Lenie, Valamarë, Guri Top, Mali i Gribës, Teqeja e Dushkut, Koshnica, Lukova, Pylli i Zi, kullotat e malit Komjan, Mali i Vinës, Mali i Tomorrit. Infrastruktura për blegtorinë përfaqësohet nga lerat, kasollet, stanet verore dhe gardhet e ndërtuara për strehimin e bagëtive dhe çobenjve gjatë verës. Të gjitha tufat që migrojnë janë të matrikulluara dhe të regjistruara në sistemin RUDA dhe pajisen me çertifikatë mjekësore veterinarë për lëvizje, në mënyrë që të parandalohen sëmundjet infektive dhe parazitare me karakter përhapës.

Gjatë verës funksionojnë shtatë baxho sezonale ku grumbullohet qumështi nga fermerët dhe përpunohet. Produkti karakteristik i zonës është djathi *stopan*, i cili shitet në tregun vendas, por edhe më gjerë.

## II.8 Gjuetia dhe peshkimi

Për shkak të moratoriumit aktual të gjuetisë së faunës së egër, ky seksion nuk ka një qëllim specifik. Statusi i gjitarëve dhe shpendëve të botës së egër karakterizohet nga një rënie e dukshme e numrit të tyre dhe nga prishja e disa prej ekuilibrave ekologjikë thelbësorë dhe habitateve të tyre, si hapja e tokave të reja bujqësore, shpyllëzimi i lartë i grumbujve cungishte të dushqeve, trugishteve, shkurreve dhe dëmtimi i bimësisë përgjatë përrenjve dhe lumenjve. Kafshët karakteristike të kompleksit të faunës janë ujku, dhelpa, ariu, lepur, pëllumbi i egër, lauresha, bufi i malit, kukapiku, bilbili, harabeli.

## II.9 Infrastruktura rekreative dhe didaktike

Siç citohet shpesh gjatë procesit të pjesëmarrjes dhe anketimit midis aktorëve lokalë (si dhe nga përfaqësuesit e bashkisë, nga fshatarët ose nga shoqata e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave), ata ndajnë mendim të përbashkët që EP Rove – ashtu si dhe ekonomitë e tjera pyjore në Gramsh –ka një potencial të mirë për të zhvilluar aktivitete rekreative dhe turistike, veçanërisht lidhur me bukuritë natyrore të kullotave verore të Roves dhe Gribës, të cilat vizitohen nga banorët vendas dhe nga qyteti. Cilësia e peizazheve të ndryshme nga niveli i mesëm mesdhetar deri në nivelin malordhe alpin ofron mundësinë për të zhvilluar infrastruktura dhe objekte turistike, bazuar në ato ekzistuese të pakta (shtigje, zona pikniku) dhe me qëllim zhvillimin e ekoturizmit midis komuniteteve lokale. Suksesi i një entiteti privat kohëve të fundit (Biofarm), i cili operon në EP Dushku i Bulçarit mund të shërbejë lehtësisht si një referencë.


Megjithatë, **pengesa kryesore dhe mbizotëruese për zhvillimin e infrastrukturës turistike të përshtatshme është gjendja mesatarisht e degraduar e rrugëve.** Aktualisht disa fshatra vështirë se mund të arrihen me automjete në disa periudha të vitit; gjendja e rrugëve dhe infrastruktura jo e mirë zgjatin kohën e udhëtimit dhe vështirësojnë transportin. **Në terma të përgjithshëm, një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar përmirësimit të rrjetit rrugor, si një parakusht për zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë lidhur me mbarështrimin e pyjeve dhe kullotave (jo vetëm turizmin).**



*Peizazhe të ekonomisë pyjore Rove*

## II.10 Prania e siteve dhe specieve me vlera të larta mbrojtjeje

Një pasqyrë e përgjithshme e zonave të mbrojtura fqinje me EP Rove dhe ekonomitë e tjera pyjore ku janë zhvilluar PMPK-të jepet me ngjyrë të kuqe në hartën më poshtë:



Sipas të dhënave të siguruar nga Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan në Mars 2021, sipërfaqja e zonave të mbrojtura për rrethin e Gramshit është 2241.41 ha, nga të cilat:

- Parku Kombëtar Mali i Tomorit (pjesa Gramsh) ka një sipërfaqe prej 1278.9 ha, shtrihet në Ekonominë Pyjore 'Jançë-Kërpicë' në njësitë administrative Kushovë dhe Skënderbegas.
- Monumentet e natyrës, 20 në total, ku: 9 bio-monumente dhe 11 gjeo-monumente, në total zënë një sipërfaqe prej 962.51 ha.

**Bashkia Gramsh është e pasur në habitate dhe shumëllojshmëri të florës dhe faunës së egër.** Nga studimet e kryera për florën dhe faunën e egër janë evidentuar mbi 40 lloje drurësh dhe shkurresh, si edhe mbi 60 lloje barishtore të florës së egër.

Speciet karakteristike të zonës: *Pinus nigra*, *Quercus cerris*, *Quercus frainetto*, *Quercus pubescens*, *Quercus trojana*, *Carpinus betulus*, *Juniperus oxycedrus*, *Cotinus coggygria*, *Arbutus unedo*, *Phyllyrea media*.

Flora barishtore: *Equisetum sp.*, *Pteridium aquilinum*, *Dactyloriza sp.*, *Fragaria vesca*, *Trifolium pratense*, *Vicia incana*, *Hepatica nobilis*, *Euphorbia amygdaloides*, *Geranium sp.*, *Bellis perennis*, *Hierachum pilosella*, *Ranunculus sp.*, *Urtica dioica*, *Cardamine bulbifera*, *Cirsium sp.*, *Cheterac officinarum*, *Hedera helix*, *Potentilla sp.*, *Oxalis pratense*, *Origanum vulgare*, *Melissa officinalis*, *Xanthium spinosum*, *Achillea nobilis*, *Mentha pulegium*, *Sambucus ebulus*, *Thymus serpyllum*, *Taraxacum officinale*, *Equisetum arvense*.

### III. Situata aktuale e pyjeve dhe kullotave


#### III.1 Mbarështrimi dhe funksionet e pyjeve dhe kullotave

##### III.1.1 Përdorimi i territorit (aktual dhe propozimet)

Sipas VKM nr. 684, dt. 2.02.2020, përdorimi i territorit në EP Rovejepet në tabelën më poshtë. Duhet të theksohet që aty përfshihet i gjithë territori i njësisë administrative, jo posaçërisht vetëm territori i mbuluar nga parcelat e pyjeve dhe kullotave që janë inventarizuar dhe analizuar për PMPK aktual.

Përdorimi i tokës (ha)	Kadastra pyjore	Përdorimi i tokës (bazuar në VKM)	Sipas Planit të Mbarështrimit 2021
Pyll	1814.8	1854.4	1894.9
Kullotë	245.87	288.9	259.03
Sipërfaqe me bimësi pyjore	14.31	52.7	
Sipërfaqe inproduktive	128.36		70.05
Tjetër		896.5	
<b>Gjithsej</b>	<b>2203.36</b>	<b>3085.5</b>	<b>2223.98</b>

Gjatë krahasimit të të dhënave të kadastrës me ato të VKM gjetëm një diferencë domethënëse, veçanërisht në kategoritë e tjera të përdorimit të tokës dhe një diferencë të vogël në sipërfaqen pyjore (+40.5 ha) dhe atë kullimore (-29.9 ha).



Nga krahasimi i të dhënave të VKM me ato të planit të mbarështrimit rezultojnë se ka diferencë të vogël në sipërfaqen e kullotave dhe asaj inproduktive. Krahas këtyre të dhënave, duhet të theksohet që burimet pyjore dhe kullimore kanë qenë nën presion në të shkuarën (mbikullotje pa lejuar ripërtëritjen natyrore të pyjeve dhe duke zvogëluar mbulesën barishtore të kullotave) me pasoja degradimi, erozioni të tokës dhe në prodhimtari. Si pasojë e emigrimit dhe një rënie të madhe demografike edhe numri i bagëtive, të cilat mbahen për nevojë vetjake të familjeve gjithashtu ka pësuar rënie në të njëjtin raport. Kjo shpie në

një presion më të ulët mbi zonat pyjore. **Pra, nuk pritet dhe as rekomandohet të shihet një zvogëlim i përdorimit të tokës pyjore në të ardhmen.**

### III.1.2 Regjimi i qeverisjes (aktuale dhe propozimet)

Ne krahasuam të dhënat e sipërfaqes pyjore sipas regjimit qeverisës ndërmjet dy planeve të njëpasnjëshëm. Lidhur me planin e mëparshëm të mbarështimit, sipërfaqja e përgjithshme sipas regjimit të qeverisjes ishte 2132.75 ha, ndërsa sipas të dhënave të siguruar nga matjet në terren të kryera në vitin 2021, sipërfaqja e përgjithshme rezultoi 2108.93ha. Vërejtëm një rritje të sipërfaqes pyjore trungishte (1.15 ha) dhe një rënie në sipërfaqet cungishte (39.25 ha).

Regjimi i qeverisjes së pyjeve në EP Rove	PMPK i mëparshëm		PMPK aktual	
	Sipërfaqja (ha)	%	Sipërfaqja (ha)	%
Trungishte	1848.75	86.5	1894.9	88
Cungishte	39.25	2		
Shkurre				
Cungishte e përbërë				
Kullotë	244.75	11.5	259.03	12
<b>Gjithsej</b>	<b>2132.75</b>	<b>100</b>	<b>2153.93</b>	<b>100</b>


Rekomandimet e planit aktual të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave synojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për inkurajimin sa më shumë të regjimit qeverisës trungishte, i cili nuk është përjashtues ndaj kullotjes në rrethana dhe periudha specifike të racionalizuara. Plani do të zbatohet duke shtuar pyllëzimin, i cili duhet të transformojë disa kullota të degraduara dhe toka të eroduar në toka pyjore, pa specifikuar një sasi përkatëse, për shkak të varësisë në sigurimin e fondeve dhe kapacitetit investues.

Formatted: Albanian

### III.1.3 Ndarja e Ekonomisë Pyjore në parcela dhe n/parcela



Lista e të gjitha parcelave dhe n/parcelave me sipërfaqet përkatëse dhe përdorimin e tokës jepet në shtojcën 1.

# Parcels of Rove



**Legend**

- Parcels
- sub\_parcels
- Administrative Unit Border of Rove
- Road - Length : 46.2 km
- Water Courses - Length : 40 km
- Water Lands - Area 1 ha




## IV. Përshkrimi i stacionit

### IV.1 Klima

Bashkia Gramsh karakterizohet nga zona klimatike mesdhetare, nënzona paramalore, ku lumi Devoll me përrenjtë që i bashkohen ka një ndikim domethënës. Klima luan një rol vendimtar për të kuptuar formimin dhe zhvillimin e vegetacionit, si edhe fenomenin e erozionit.

Sipas të dhënave të regjistruara nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujrave dhe Mjedisit (IGJEUM), temperatura mesatare vjetore është 10.9°C dhe reshjet mesatare mujore janë 82.2 mm.

Muajt	Temperatura (°C)	Reshjet (mm)
Janar	1.1	108.6
Shkurt	2.3	93.6
Mars	5.6	91.8
Prill	9.8	70.4
Maj	14.3	68.2
Qershor	18.3	57.5
Korrik	20.9	34.3
Gusht	21.1	35.1
Shtator	16.5	85.7
Tetor	11.6	102.5
Nëntor	7.3	115.0
Dhjetor	2.5	123.3



Mund të shtohet që shuma e orëve me diell i afrohet 2000 të tillave. Në zonat malore të EP, pozicioni topografik ka një ndikim të madh në kohëzgjatjen e diellëzimit, cili përcakton se sa i hapur apo i mbyllur është horizonti, gjithashtu ndikon tek reshjet nëpërmjet krijimit të mikroklimave të shumta. Kështu që, kundrejtimit jugore, veçanërisht gjatë muajve Nëntor, Dhjetor dhe Janar marrin 3-4 herë më shumë ngrohtësi se sa kundrejtimit veriore dhe sasia më e madhe e ngrohtësisë përftohet kur pjerrësia i kalon 45 gradët. Lidhur me reshjet, në kundrejtimit perëndimore sasia e reshjeve është 300 mm më e lartë se sa në kundrejtimit lindore. Dëbora është e zakonshme për fshatrat që ndodhen më lartë se 700 m mbi nivelin e detit, pasi ajo mund të qëndrojë në lartësitë e mëdha nga Dhjetori në Prill. Era karakterizohet nga drejtimit veriore dhe verilindore gjatë periudhës së ftohtë me shpejtësi 15 m/sec dhe më rrallë deri 30 m/sec (nëpër lugina). Erërat perëndimore fryjnë kryesisht në stinën e verës kur kontrasti i temperaturave të detit dhe ujrave kontinentale është më i madh.


Mund të theksohen dy veçori madhore me efekte dëmtuese potenciale mbi mbulesën e vegjetacionit. Nga njëra anë, thatësira që del në pah nëpërmjet diagramës termo-pluviometrike të Gausen-it për muajt e Korrikut dhe Gushtit, me periudhë më të gjatë dhe me efekte më intensive në zona të ndryshme për shkak të kushteve të relievit: **edhe pse së fundmi janë vërejtur pak tharje drurësh, kjo mund të ndikojë prodhimtarinë, gjendjen fitosanitare dhe vitalitetin e disa grumbujve pyjorë në të ardhmen lidhur me efektet e ndryshimit klimatik.** Nga ana tjetër, reshjet e dendura mesdhetare në këto zona malore janë shkak i origjinës së fenomenëve të erozionit dhe rrëshqitjes së tokës, të cilat mund të ndodhin jashtëzakonisht shpejt kur nuk ka mbulesë vegjetacioni.

## IV.2 Topografia dhe morfologjia

Lartësia mbi nivelin e detit përgjatë EP Rove varion nga 550 m deri në 2030m (vargmalet e Vërçes dhe Maja e Gurit), me një lartësi mesatare prej 1493 m, e cila konsiderohet mjaft e lartë në kuadër të Bashkisë Gramsh. Në këtë reliev ngrihen shpate të pjerrët, të cilët ndikojnë në mënyrë të ndjeshme vetitë e tokës dhe vegjetacionin e hasur. Kjo veçori, gjithashtu, nxjerr në pah nivelin e lartë të rrezikut të erozionit dhe rrjedhimisht nevojën për ruajtjen e duhur të mbulesës pyjore dhe vegjetacionit për mbrojtjen e tokës. **Mbarështrimi i pyjeve dhe kullotave në EP Rove duhet të integrojë si tepër të rëndësishëm funksionin mbrojtës.** Tabela dhe grafiku mëposhtë japin të dhëna më të hollësishme. Ato veçanërisht tregojnë pjerrësinë mesatare prej 25.2° (që i korrespondon me 47.1%) të EP Rove.

Kategoritë e pjerrësisë (gradë)	Ndarja e sipërfaqes së EP Rove sipas pjerrësisë (ha)	% e EP Rove
0-10	395	13%
10-20	1192	39%
20-30	1054	34%
30-40	359	12%
40-60	58	2%

Ndarja e EP Rove sipas kategorive të pjerrësisë në °



■ 0-10° ■ 10-20° ■ 20-30° ■ 30-40° ■ 40-60°

# Altitude of Rove





**Legend**


- Parcels
- Sub Parcels
- Administrative Unit Border of Rove

**ELEVATION - Avarage 1493.1m**

- 550.000 - 660.000
- 660.001 - 1250.000
- 1250.001 - 1550.000
- 1550.001 - 1800.000
- 1800.001 - 2030.000



# Slope of Rove





**Legend**


- Parcels
- Sub Parcels
- Administrative Unit Border of Rove

**Slope - Average : 25.2°**


- 0 - 10°
- 10 - 20°
- 20 - 30°
- 30 - 40°
- 40 - 60°



Duke marrë në konsideratë konfigurimin e përgjithshëm të ekonomisë pyjore, si edhe rrjedhën e përrenjve kryesorë (Kukurit dhe Gribës), rezulton që kundrejtimi i përgjithshëm është më tepër verior.



Lartësitë mbi nivelin e detit, kundrejtimet dhe pjerrësitë e ndryshme krijojnë kushte të favorshme për tipe vegjetacioni biogeografike të ndryshme, nga niveli mesdhetar i mesëm deri në nivel malor. **Kjo siguron interes potencial për aktivitete rekreative, si psh.ecja malore dhe për peizazhin**, pasi pozicioni i përgjithshëm i EP Rove qëndron mbi disa lugina dhe vargmale të gjera me pamje spektakolare të malit të Tomorrit në sfond. Disa shembuj të vlerave të peizazhit për aktivitete rekreative jepet në fotot mëposhtë të marra nga EP e Bashkisë Gramsh.




*Pamje nga peizazhet e ofruara në territorin e bashkisë Gramsh*


### IV.3 Gjeologjia

Formacionet sedimentare janë dominues në EP Rove. Kjo përfshin shistet paleozoike, depozitimet e vjetra dhe të reja të flysheve, si edhe depozitimet e molasës. Shkëmbinjtë në pjesët e epërme janë modeluar në epokën e kuaternarit përmes erozionit akullnajor, liqeneve të vogla ujëmbledhëse dhe masiveve akullnajorë. **Komponimet sedimentare shfaqin fenomenin e erozionit intensiv** në shumë vende, i cili është në origjinë të pellgjeve ujëmbledhës dhe një rrjeti kompleks hidrografik që ndërpret kreshtat. **Ato shpjegojnë format e thyera të relievit dhe bimësinë relativisht të varfër** ku roli i vegjetacionit pyjor duket qëështë i kufizuar.


# Geology of Rove



- Legend**
- Geology**
- Eocene
  - Lower Oligocene
  - Maastrichtian
  - Middle Jurassic
  - Middle Triassic
  - Paelocene-Eocene
  - Pleistocene Holocene
  - Triassic Jurassic
  - Upper Cretaceous
  - Upper Jurassic
  - Upper Triassic
  - Administrative Unit Border of Rove



1:25,000



## IV.4 Tokat

Shtresa tokësore (dheu) është shumë e ndryshme në drejtim të cilësive morfologjike, kimike, fizike dhe vetitë mineralogjike, si edhe përmbajtjes së gurëve. Kombinimi i relievit, klimës, bimësisë dhe përbërjes së shkëmbit amnor krijon toka të veçanta me cilësi të veçanta, ku mikroorganizmat e gjalla luajnë një rol kryesor në proceset pedogjenetike, veçanërisht në qarkullimin e lëndës organike dhe energjisë. Në kontekstin e EP Rove, **relievi është një faktor kyç për të kuptuar diversitetin**, pasi ndikon direkt tek klima dhe proceset fiziko-kimike dhe biologjike të tokë formimit, në zhvendosjen e elementëve ushqyes dhe produkteve dhe në lëvizjen e ujrave dhe regjimet ujore. Në këto kushte, **relievi është themelor për të vlerësuar kapacitetin e rritjes dhe ekuilibrin ujor të tokës**. Për shembull, në shpatet e pjerrëta infiltronhet më pak ujë se sa në tokat e sheshta. Në rastin e parë uji kalon në sipërfaqe duke shkaktuar erozion dhe varfërimin e elementëve ushqyes të tokës. Kjo është veçanërisht e dukshme kur toka është e zhveshur nga bimësia, e shqetësuar nga faktorë të ndryshëm siç janë mbishfrytëzimi në grumbujt pyjorë, si edhe shkelja nga kafshët në toka të pastrukturuara. **Prandaj, aktivitetet njerëzore në ekonominë pyjore kanë një ndikim aktiv në cilësinë dhe funksionalitetin e tokës.**

Duke iu referuar hartës pedologjike të Shqipërisë, që paraqitet më poshtë, dhe klasifikimit të FAO-WRB të tipeve të tokave, tokat në EP Rove janë kryesisht Mollic Kambisole (Mollic Cambisol), Rodik Luvisole (Rhodic Luvisol), Distrik Kambisole (Dystric Cambisol). Shpërndarja e tyre bëhet sipas lartësisë mbi nivelin e detit.


Tokat e hinjta kafe zënë pjesën më të vogël të ekonomisë pyjore. Ato i korrespondojnë tokave *mollic cambisol* dhe zënë pjesën më të madhe të sipërfaqes nga luginat deri në lartësinë 500-600 mbi nivelin e detit. Përgjithësisht ato përfaqësojnë një profil të diferencuar, pasi ngjyra e horizontit të sipërm A është e zbehtë dhe horizonti B dhe C janë në ngjyrë gri në të verdhë. Përbërja mekanike (tekstura) është subargjilore e mesme. Sipas inventarizimit në sipërfaqet provë, trashësia e lëgushës dhe humusit kryesisht është më pak se 3 cm, dhe atje ku kalohet kjo trashësi, shkon nga 3 deri 5 cm.

Tokat e kafentashtrihen përgjithësisht shtrihen në lartësitë nga 500-600 m deri në 800-1100 m mbi nivelin e detit, ndërsa në disa raste ato takohen edhe mbi këto lartësi. Ato kryesisht janë takuar në EP Rove.

Horizonti A ka ngjyrë kafe me teksturë subargjilore të mesme. Horizonti B ka një ngjyrë më të hapur dhe përbërje mekanike më të rëndë. Këto toka dallohen për përbërjen e tyre kimike me aciditet të ulët me kompleks thithës koloidal të saturuar me baza, me përmbajtje humusi të ulët deri mesatare.

Në drejtim të karakteristikave mekanike dhe minerale, ato përgjithësisht janë toka të lehta me pjellori të ulët. Përmbajtja e lëndës organike në këto toka është e ulët, duke çuar në kushte vegetative të varfra për grumbujt e dushqeve dhe shkozës. Tokat janë të cekëta, më pak se 30 cm dhe përgjithësisht të thata. Trashësia e horizontit të lëgushës dhe humusit është kryesisht më pak se 5 cm.

# Soil Type of Rove



**Legend**

- Parcels
- sub\_parcels
- Administrative Unit Border of Rove

**Soil Type**

- Dystric Cambisol
- Mollic Cambisol
- Rhodic Luvisol



Tokat e murrme pyjore shtrihen në altitudat nga 1000 – 1500 m mbi nivelin e detit, ku takohet shumica e pyjeve trungsishte. Tokat janë të lehta, të thata dhe të cekëta. Vegetacioni barishtor i inventarizuar në terren, i tillë si Oxalis acetosola dhe Anemone nemerosa tregon për aciditetin e tyre. Kanë teksturë argjilore të mesme. Trashësia e humusit është mesatare, nga 3 deri 5 cm. Gjetet në formacione magmatike serpentimore, me reaksion neutral ose lehtësisht acid në pyjet e Ahut dhe Lajthisë dhe acid në pyjet e pishës. Përgjithësisht, këto toka kanë një profil të diferencuar. Në parcelat ku nuk ka kullotje dhe aktivitet të erozionit ato fillojnë me nënhorizontin A<sub>0</sub> me një shtresë lëgushe 3-4 cm. Poshtëkëtij nënhorizonti vjen horizonti humusor, me ngjyrë të murrme, përbërje mekanike subargjilore të mesme dhe strukturë granulare. Pas horizontit humusor vjen horizonti B me trashësi 20-50 cm me ngjyrë të kafenjtë të zbehtë dhe përbërje mekanike subargjilore. Horizonti C përbëhet nga produkte të tjetërsuara dhe është më i zbehtë në ngjyrë se horizontet e sipërme. Ai përmban më pak fosfor krahasuar me elementët e tjerë. Karakteristikë e veçantë e tyre është mos saturimi me baza argjiloro-ranore flyshore dhe shkëmbin amnor.

Lidhur me kullotat, tokat livadhore-malore kanë një shpërndarje të kufizuar. Horizonti humusor ka një trashësi prej 10-40 cm, me ngjyrë të kafenjtë të errët, ndërsa përbërja mekanike është subargjilore e mesme. Horizonti iluvial ka një trashësi prej 20-50 cm, me ngjyrë të verdhëreme në të kafenjtë. Poshtë këtij horizonti gjendet horizonti C, i cili përfaqësohet nga produkte alkaline të tjetërsuara. Në drejtim të përbërjes kimike, janë toka me reaksion neutral deri në lehtësisht acid, kanë përmbajtje të mirë humusi dhe azoti dhe një shkallë të vogël të saturimit me baza ( $Ca^{++} + Mg^{++} = 7-8 \text{ mek}/100 \text{ gr tokë}$ ). Këto janë toka mesatarisht të pasura në elementë ushqyes.

Si përfundim, tipet e tokave të përshkruara sipas klasifikimit të FAO-WRB rezultojnë në humbje të shtresave sipërfaqësore dhe mungesë domethënëse të humusit dhe procesit të mineralizimit për shkak të përdorimit intensiv të biomasës drunore dhe mbi të gjitha për shkak të largimit masiv të elementëve ushqyes nga kullotja e bagëtive. Kjo ka bërë që e gjithë ekonomia pyjore të jetë në presion të vazhdueshëm, veçanërisht kur lastarët e rinj sapo dalin nga cungjet apo ata që rriten në nënpyll kulloten nga bagëtisë. **Si rrjedhojë, tokat shfaqen të degraduara, duke ofruar një mesatare të ulët të rritjes vjetore nga 1 deri 5 m<sup>3</sup> për hektar në vit, ndonëse kushtet e përgjithshme bio-klimatike janë të përshtatshme për një prodhimtari më të lartë.**

## IV.5 Rrjeti hidrologjik dhe burimet e furnizimit me ujë

EP Rove ka një rrjet hidrologjik të dendur, kryesisht me prurje gjatë stinëve dimër-pranverë. Kjo për shkak të formacionit gjeologjik dhe formave të çregullta të relievit, si edhe rolit të zvogëluar të bimësisë pyjore, veçanërisht të nënpyllit që mundëson mbrojtjen e tokës nga erozioni. Përgjatë ekonomisë pyjore dhe në afërsi të saj mund të përmendim përrrenjtë e Gjaçit, Gribës, Irmathit, Saraselit, Qanolit and Kishevicës që derdhen në lumin e Vërçës. Ky rrjet hidrologjik t, hera pas here pjesërisht nëntokë (mali i Kukurit, Gribës dhe Komjanit) karakterizohet nga **përroska të thella në shpate, të cilat mund të mbushen lehtësisht nga reshjet intensive mesdhetare.**

Ndër burimet natyrore të ekonomisë pyjore dhe atyre fqinje janë burimet ujore të Kukurit, Gribës dhe Sojnikut. Këto burime ujore përdoren nga fshatarësia jo vetëm për ujë të pijshëm, por gjithashtu edhe për vaditjen e tokave bujqësore. **Në këtë drejtim, mungesa e ujit për vaditje shpesh citohej nga banorët gjatë anketimit si kufizimi kryesor për zhvillimin e bujqësisë brenda kufijve të ekonomisë pyjore Rove.**

Harta e parcelave e paraqitur në seksionin III.1.3 paraqet gjithashtu vendndodhjen e përrenjve dhe trupave ujorë në të gjithë ekonominë pyjore, mëposhtme paraqet vendndodhjen e përrenjve dhe trupave ujorë në të gjithë ekonominë pyjore, me një gjatësi të përgjithshme prej 40 km dhe sipërfaqe të përgjithshme prej 1 ha të trupave ujorë.



*Foto ilustruese e rrjetit hidrologjik në EP Rove*

## IV.6 Erozioni në sipërfaqet e pjerrëta dhe rrjedhat ujore

Sikurse përshkruhet në pjesët e mësipërme, erozioni shfaqet gjerësisht dhe në mënyrë intensive përgjatë ekonomisë pyjore, prandaj mbrojtja e tokës përfaqëson një interes thelbësor. Kështu, erozioni ka pakësuar sasinë e humusit organik dhe ka kufizuar vetitë e tij fizike dhe mekanike, duke çuar në një rënie të përgjithshme të pjellorisë së tokës dhe normat e rritjes vjetore për pyjet dhe kullotat. Faktikisht, reshjet e befta të shiut, shpesh në sasi të mëdha dhe me intensitet të lartë, shtrirja e formacioneve të buta sedimentare lehtësisht të gërryeshme dhe mbikullotja dhe degradimi i pyjeve gjenerojnë erozion aktiv dhe të thellë. Vlerësohet që shpëlarja e elementëve ushqyes nga erozioni në këtë pellg ujëmbledhës arrin 445 ton/km.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar rolit vendimtar të pjerrësisë në këtë fenomen. Shpatet me pjerrësi më pak se 5% janë më pak të rrezikuara nga erozioni, megjithatë për shpatet me pjerrësi 5-25% rreziku është mesatar dhe bëhet më i lartë kur pjerrësia është mbi 25%. Me një pjerrësi mesatare prej 25.2° (që i korrespondon 47.1%), **pjesa më e madhe e EP Rove mund të konsiderohet me rrezik të lartë erozioni**, veçanërisht pasi gjatë periudhave të fundit janë shtuar faktorët rëndues nëpërmjet shpyllëzimeve masive, mbikullosjes, degradimit të bimësisë dhe humbjet e tokës. Për më tepër, brigjet e lumenjve zakonisht nuk janë të veshur me bimësi përgjatë rrjedhave ujore, çka çon në zgjerimin e shtratit të lumenjve dhe përshpejtimin e erozionit.

Kjo situatë ka një ndikim madhor në mbarrështrimin e pyjeve dhe kullotave për këtë plan. Roli parandalues që luan bimësia pyjore ekzistuese është i pari që sillt ndërmend: Kjo bimësi zvogëlon forcën goditëse të pikave të shiut mbi sipërfaqen e tokës, ruan dhe ngadalëson rrjedhjen sipërfaqësore të ujit të shiut, duke krijuar kushtet për t'u përthithur nga toka, duke e pasuruar tokën me lëndë organike, shmangur erozionin dhe rritur pjellorinë e tokës. **Prandaj është e një rëndësie parësore të zbatohet një sistem për të mbrojtur ripërtëritjen e pyjeve dhe rimëkëmbjen e bimësisë duke ndaluar kullotjen për një periudhë të mjaftueshme dhe të duhur.** Ky sistem mund të përfshijë përjashtimin e të gjitha sipërfaqeve trungishte të brishta nga kullotja gjatë periudhës së këtij PMPK dhe një rotacion 5 vjeçar për praktikën e kullotjes për të mundësuar ripërtëritjen shkurreve dhe cungishteve. Masa të tjera si pyllëzimet, gardhimet, pritat malore dhe muraturat e gurit do të jenë të dobishme gjithashtu.

Ngjarjet kryesore të erozionit që janë vërejtur gjatë inventarizimit në terren janë hedhur në hartën zyrtare të rrugëve pyjore, infrastrukturës dhe sipërfaqeve të degraduara.



*Shembull i erozionit të shkaktuar nga mungesa e vegjetacionit drunor dhe barishtor (fillesa e fenomenit në të majtë dhe situata e rënduar në të djathtë). Fotot e bëra në ekonomitë pyjore të Gramshit.*

## IV.7 Rrëshqitjet e tokës

Në lidhje me kushtet e hasura, të cilat gjenerojnë një shkallë të lartë erozioni siç përshkruhet në pjesën IV.6, rrëshqitjet e tokës gjithashtu paraqesin një rrezik, veçanërisht kur janë në diskutim objekte të tilla si ndërtesa, rrugë, ura, diga dhe për aktivitetet që kryhen rregullisht nga banorët (tokat bujqësore). Në këtë aspekt, rrëshqitja e tokës është njëçështje e rëndësishme në EP Rove. Kështu, **infrastruktura dhe zonat e banuara pranë spoteve me erozion aktiv, shpateve të pjerrëta dhe lumenjve që janë të prirur për dalje nga shtrati duhet të kontrollohen rregullisht për sa i përket rrezikut të rrëshqitjeve të tokës.** Krahas kësaj, ndërtimet e reja duhet të planifikohen dhe konfirmohen vetëm pas studimeve të fizibilitetit.



*Pasajat e një rrëshqitje tokë të mëparshme në EP Rove*

## V. Vegjetacioni dhe biodiversiteti

### V.1 Brezat bio-klimatikë

EP Rove bën pjesë në dy zona fitoklimatike:


- Zona fitoklimatike e Gështenjës (Castanetum);
- Zona fitoklimatike e Ahut (Fagetum).

Zona fitoklimatike Castanetum kufijet e saj normalë të shtrirjes i ka deri 700 m mbi nivelin e detit, por në këtë EP kufijtë shpesh shtrihen në lartësi më të mëdha dhe mund të gjendet edhe në lartësitë 1000-1100 m mbi nivelin e detit. Lidhur me zonën fitoklimatike Fagetum, lloji kryesor më i hasur është Ahu.


### V.2 Pyjet dhe kullotat

Ndarja e përgjithshme ndërmjet pyjeve, shkurreve, kullotave dhe të tjera (sipërfaqe shkëmbore, djerrë, rrjeti hidrologjik, sipërfaqe ujore ...) në EP Rove paraqitet më poshtë. Duhet përmendur që këto të dhëna i referohen vetëm parcelave, të cilat u inventarizuan në terren (ndryshe nga të dhënat e ofruara në pjesën III.1.1 për të gjithë njësinë administrative).

Sip. totale (ha)	Pyje (ha)	Pyje (%)	Kullota (ha)	Kullota (%)	Tjetër (ha)	Tjetër (%)
<b>2223.98</b>	1894.9	84.90%	259.03	11.90%	70.05	3.20%





# Land Use of Rove



**Legend**

- Parcels
- Administrative Unit Border of Rove
- Land Use**
- Forest
- Pasture
- Open space
- Unreachable



### V.3 Tipet pyjore

Në shkallë ekonomie pyjore, tipet e pyjeve shpërndahen siç tregohen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tipi i pyllit "Pyje të dominuar nga ..."	Sipërfaqja	% e totalit të	% e totalit të
Pyje të dominuar nga Ahu	1743.76	91.83%	77.96%
Pyje të dominuar nga Bredhi i bardhë	78.44	4.24%	3.60%
Pyje të dominuar nga Pisha e zezë	49.58	2.68%	2.28%
Pyje të dominuar nga Qarri	12.58	0.68%	0.58%
Pyje të dominuar nga Panja	4.99	0.27%	0.23%
Pyje të dominuar nga Rrobulli	1.85	0.10%	0.08%
Pyje të dominuar nga Ashja	0.92	0.05%	0.04%
Pyje të dominuar nga Shkoza	0.92	0.05%	0.04%
Pyje të dominuar nga Ahu i Motesianit	0.74	0.04%	0.03%
Pyje të dominuar nga Pisha e butë	1.10	0.03%	0.05%
<b>Totali</b>	<b>1894.9</b>	<b>1.00</b>	<b>84.90%</b>

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)


Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)



## V.4 Tipet e kullotave

Për shkak të lartësisë së madhe mbi nivelin e detit, të gjitha kullotat në EP Rove janë kullota verore.

Tipi i kullotës	Sipërfaqja ha	% of totalit të sipërfaqes kullosore
Kullotë verore	259.03	100%
Kullotë dimërore	0	0%

## V.5 Tipet e vegetacionit potencial

Bazuar në tipet e raportuara nëpërmjet planeve të mëparshme të mbarështrimit, tipet kryesore të vegetacionit potencial, me mbulimin e tyre nëpërqindje të sipërfaqes së përgjithshme të vegetacionit, mund të përshkruhen të shoqëruara me florën dhe speciet treguese (indikatore).

- Formacione të përziera të shknozës zënë 71%, që i përkasin tipeve të shkurreve dhe shoqërohen me specie të tjera të tilla si ahu, lisi, dëllinja, cermedeli, frashëri, lofata dhe bimësinë barishtore belisma e zezë (*Chrysopogon gryllus*), fengu (*Andropogon ischaemum*), *Vulpia myuros*.
- Formacione të tjera të ngjashme zënë 12% të sipërfaqes dhe përbëhen nga tipe më specifike të cungishteve të ahut shoqëruar me frashër.
- Formacionet me pishë, ndër të cilët shumica me pishë të zezë zënë 14%. Këto pyje kanë një zhvillim mesatar dhe nënpylli përbëhet nga shkoza, cermedeli dhe dëllinja.
- Formacionet e dushqeve zënë 2% të sipërfaqes dhe karakterizohen nga lloje të ndryshme dushqesh, të cilët në shumë raste janë të përzier: qarr, shpardh, bungë, bungëbutë. Veç kësaj, ata mund të gjenden zakonisht të dominuar nga shkurre të ndryshme si shkoza, cermedeli, murrizi dhe lloje të tjera gjegjerëse të tilla si molla e egër, frashëri i bardhë. Formacionet e dushqeve shoqërohen nga bimësia barishtore me specie si belisma e zezë, fengu, telishi (*Dactylis glomerata*), luledele, *Lathyrus venetus*.
- Së fundmi, formacionet e gështenjës zënë 1% të sipërfaqes dhe janë të dëmtuara kryesisht nga shfrytëzimi dhe kullotja e paqëndrueshme.

Këto përshkrime janë përditësuar me të dhënat e mbledhura gjatë matjeve në sipërfaqet provë për gjatë inventarizimit të këtij PMPK, duke iu referuar tipeve e vegetacionit potencial, siç paraqiten më poshtë.

Tipet e vegetacionit potencial (përshkrim nga inventarizimi i pyjeve)	% e totalit të sipërfaqes së vegetacionit
Formacione pyjore Ahu me Bredh të bardhë në shkëmbinj gëlqerorë	93.6%
Formacione pyjore me Pishë të zezë, Bredh të bardhë dhe Frashër në shkëmbinj gëlqerorë dhe serpentinorë	4.5%
Formacione pyjore dushqesh (Shpardh, Qarr)	1.7%
Formacione pyjore Ahu dhe Bredhi të Maqedonisë në toka gëlqerore	0.2%

## V.6 Biodiversiteti

**Mbrojtja e natyrës, biotopeve, habitateve dhe specieve të rrezikuara është pjesë procesit të mbarështrimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave. Këto elementë janë një instrument për përmirësimin e territorit me rëndësi për ruajtjen, por gjithashtu me ndikime potenciale pozitive socio-ekonomike.**

Identifikimi i këtyre vlerave është bërë nëpërmjet disa burimeve si më poshtë:

- Përmbajtja dhe treguesit nga planet e mëparshme të mbarështrimit;
- Informacioni nga aktorët dhe banorët lokalë gjatë proceseve pjesëmarrëse;
- Vëzhgimet direkte në terren dhe mbledhja e të dhënave nëpërmjet matjeve në sipërfaqet provë;
- Raporti i vitit 2019 për kushtet e mjedisit nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve
- Dokumenti i politikave pyjore kombëtare të Shqipërisë 2019 – 2030 nga MTM.

Në përgjithësi, në territorin shqiptar gjenden 3250 specie bimore ose 29% e florës evropiane, një përqindje veçanërisht e lartë krahasuar me sipërfaqen relativisht të vogël të vendit. E thënë ndryshe, pavarësisht se Shqipëria përfaqëson 7% të gadishullit të Ballkanit, këtu gjenden 47% të florës së Ballkanit. Rreth 1% e kësaj flore i përket specieve endemike, ose ndryshe, janë specie që rriten vetëm në Shqipëri. Duke marrë në konsideratë speciet sub-endemike (ato që shtrihen deri në vendet fqinje Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë Veriore, Greqi), ky raport arrin deri në 5% të florës shqiptare. Prandaj dhe, Shqipëria cilësohet si një nga vendet më të pasura në Evropë lidhur me biodiversitetin dhe endemizmin.

Në këtë kuadër, **Bashkia Gramsh është përfaqësuese e kësaj shkalle të lartë biodiversiteti dhe endemizmi**, ndonëse nuk përfshihet në sitet e biodiversitetit me prioritet parësor në nivel kombëtar siç përshkruhet në raportin e vitit 2019 të gjendjes së mjedisit nga AKM. Kjo përfaqësueshmëri është veçanërisht **për shkak të gamës së gjerë të kushteve bio-klimatike të hasura** (nga niveli meso kserofit mesdhetar deri në nivelin malor dhe sub-alpin) **në saje të lartësive të ndryshme, kundrejtiveve, relievit të fragmentuar, formacioneve shkëmbore dhe tokave.**

Sipas të dhënave të grumbulluara në terren në EP dhe krahas rezultateve të paraqitura në seksionin II.10, speciet endemike dominante që gjenden janë: *Lisra*, *Lulebasani haplofiloid*, *Rudithi shqiptar*.

Ndër speciet e rrezikuara kryesisht mund të përmenden:

- *Atropa bella-dona*, Malore Mesdhetare;
- *Hypericum perforatum*, Paleotemperuar;
- *Origanum vulgare*, Euroaziatike;
- *Satureja montana*, Orofite-Mesdhetare;
- *Juniperus oxycedrus*, Mesdhetare Euri, heliofite;
- *Agrimonia eupatoria*, kozmopolite, heliofile;
- *Dryopteris filix-mas*, pothuajse kozmopolite.

Edhe pse sezoni i kryerjes së inventarizimit në terren nuk ishte më i përshtatshmi për të vëzhguar biodiversitetin (për shkak të afatit të shkurtër kohor nga Nëntori 2020 deri në fund të Prillit 2021 pa mundësi shtyrje), të dhënat e mbledhura gjatë inventarizimit evidentuan praninë e *Cynodon dactylus* në n/parcelat 12c, 22e dhe 39b.

Së fundmi, është e rëndësishme të raportohen vëzhgimet e drurëve të tharë, duke qenë se ata zakonisht shoqërohen me një nivel të lartë biodiversiteti lidhur me habitatet specifike të entomofaunës (*insektet*), avifauna (*shpendët*) dhe kiropterët (*lakuriqët*). Në kontekstin e EP Rove është edhe më e dukshme që presioni mbi burimet drusore (shfrytëzimi, për qëllime familjare, kullotje, blegtori) ka qenë veçanërisht i rëndësishëm gjatë dekadave të fundit. Kështu, sipas inventarizimit, drurët e tharë zinin më tepër se 20% në n/parcelën 5a, deri në 50% në n/parcelën 1b dhe deri në 95% në n/parcelën 1c.


## V.7 Prania e vlerave të larta mbrojtëse

Duke iu referuar listës të udhëzuesit të vitit 2018 në lidhje me vlerat e larta mbrojtëse (VLM) dhe krahas informacionit të raportuar mësipër (VLM rreth diversitetit të specieve), vëzhgimet nga sipërfaqet provë theksuan site të tjera me vlera të larta.

Për ekosistemin dhe mozaikët e nivelit të peizazhit (HCV 2), u bënë vëzhgime specifike në n/parcelat 19 c dhe 32 a.

Për sa i përket ekosistemeve dhe habitateve (HCV 3), vëzhgimet specifike nga inventarizimi në terren korrespondojnë me n/parcelat 1b dhe c, 3b, 7a, 8b, 10a, 11a, 12b, 13b, 17b, 18a, 22a dhe e, 25a, 26a dhe c, 27a dhe c, 29a, 30b, 33a, 38a, 42b. Gjithashtu, u bë vlerësimi i **shkallës së pjekurisë** për grumbujt pyjorë trungishte me një theks të veçantë për grumbujt e pjekur dhe të moçëm lidhur me vlerat mbrojtëse.

Formatted: Italian (Italy)



Për më tepër, përmes parcelave të maturave vlerësuanedhe shërbimet specifike të ekosistemit (VLM 4). **Kështu, funksioni mbrojtës ndaj tokës, u raportua në n/parcelat 7d, 8c, 13a, 19d.**


Lidhur me vlerat e larta mbrojtëse të tjera, disa parcela u vlerësuan për nevoja të komunitetit për prodhimin e frutave (VLM 5), konkretisht n/parcelat 2a, 6a, 8b dhe c, 11a, 14c, 15b, 16a, 18b dhe e, 19b, 22a dhe e, 25a dhe b, 26a dhe d, 27a dhe c, 28a, 29a, 30a, 33b, 34b, 37a, 38b, 39b.

Së fundmi, sipas të dhënave të siguruar nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura të Elbasanit në Mars 2021, në lidhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM), nr. 676, datë 20.12.2002 "Për

shpalljen si zona të mbrojtura të Monumenteve Shqiptare të Natyrës” dhe VKM nr. 303, datë 10.05.2019 “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve shqiptare të natyrës”, në EP Rove ka një një monument natyretë shpallur zyrtarisht, i quajtur “Ahishtja e Roves” që shtrihet në 55.65 ha.

## V.8 Rreziku për biodiversitetin dhe efektet mbi planifikimin

Duke iu referuar të dhënave në përshkrimin e parcelave dhe nën parcelave, mund të përcaktohet statusi aktual i elementëve ekzistues të biodiversitetit dhe llojete kërcënimeve. Kështu, **një rrezik specifik për biodiversitetin u vlerësua të jetënë 6% të sipërfaqes së përgjithshme të EP që përfaqëson një nivel jo të lartë**. Më hollësisht, llojet e rreziqeve dhe rëndësia e tyre krahasuar me njëri-tjetrin jepet përmes grafikut të mëposhtëm.



Për më tepër, duhet të theksohet se nga 6 ngjarje të raportuara gjatë inventarizimit në terren (p.sh. përgjatë rrugës nga sipërfaqet provë të përhershme tek ato të përkohshme), 4 prej tyre i përkisnin dëmeve nga zjarri dhe 2 prerjeve të paligjshme.

## V.9 Mundësitë për aktivitete didaktike dhe kërkimore

Sipas bisedave të zhvilluara me Kryetarin e Bashkisë së Gramshit dhe përfaqësuesit pjesëmarrës në serinë e takimeve të zhvilluara në fshatra, **u shpreh qartë dëshira për të zhvilluar funksionin turistik dhe rekreativ në EP Rove**, megjithëse realizueshmëria e një projekti konkret nuk ishte studiuar saktësisht. Pavarësisht se EP Rove ndodhet relativisht larg qytetit të Gramshit dhe rrugëve publike kryesore, mundësia duket e lartë për të vlerësuar peizazhin spektakolar të ofruar, mundësinë shtigjeve për ecje malore dhe atmosferën rurale, duke zhvilluar një ofertë për ekoturizmin me përfshirjen e palëve të interesuara lokale.

Më tej, **duhet të zhvillohen gjithashtu aktivitete rekreative dhe didaktike drejt komuniteteve lokale** për rritjen e ndërgjegjësimit të fshatarëve për të drejtat e tyre të përdoruesit, për përvetësimin embarështrimit të burimeve në një mënyrë më të qëndrueshme, për të krijuar ndërveprime të reja midis stafit bashkiak të pyjeve dhe palëve të interesuara lokale, si dhe për fillimin e programeve studimore për edukimin mjedisor.

Në përgjigje të një kërkesë specifike nga konsulenca drejtuar Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura të Elbasanit, u bë me dije se ata kryejnë kërkime, monitorime dhe vëzhgime të vazhdueshme mbi gjendjen e habitateve, monitorimin dhe studimin e florës dhe faunës së egër në Parkun Kombëtar të Malit Tomor dhe në NJA-të që ndodhen në afërsi të tij.




*Foto ilustruese e nje peizazhi spektakolar të ofruar nga EP Rove*

## VI. Rrugët dhe infrastruktura

### VI.1 Rrugët pyjore

Si rezultat madhor nga takimet e larmishme të zhvilluara në Bashkinë Gramsh, si dhe brenda kufijve të EP Rove, **funksionaliteti i rrjetit rrugor në përgjithësi dhe i rrugëve pyjore në veçanti u përmend kryesisht si një faktor kyç që ka nevojë për t'u përmirësuar, lidhur si me mirëmbajtjen e tyre ashtu dhe mundësinë për të përmirësuar ato të ndërtuara në tokë natyrore (rrugë dheu) duke i shtruar me çakull ose asfaltuar ato.** Në kontekstin e një tendence intensive të largimit të banorëve nga zonat rurale, ajo që është në rrezik është perspektiva për një zhvillim më të mirë të EP në lidhje me burimet e pyjeve dhe kullotave, por gjithashtu përtej aspekteve ekonomike të përgjithshme (bujqësi, turizëm) edhe atraksioni i përgjithshëm i EP Rove.

Harta e mëposhtme jep një pasqyrë të rrjetit rrugor me gjatësi të përgjithshme prej 46.2 km, sipas të dhënave të siguruara nga Bashkia Gramsh për këtë temë.



Më hollësisht dhe gjithashtu duke marrë parasysh afërsinë e EP Rove (për të analizuar lidhjet midis territoreve), fshatrat midis ekonomisë pyjore janë të lidhura me rrugë automobilistike. Rrugët kryesore janë rruga që lidh Kukurin me fshatin Rashtan dhe rruga që lidh fshatin Gribë me fshatin e Irmathit, si edhe rruga Gramsh – Kukur, e cila nuk ka qenë mirëmbajtur rregullisht.

Gjendja dhe mirëmbajtja e rrjetit të rrugëve pyjore kanë vështirësi të dukshme, me mungesën e zakonshme të punimeve për rregullimet e ujrave, korrigjimin e pjerrësisë dhe mureve për stabilizimin e tokës. **Para se të shqyrtohet bërja e rrugëve të reja, duhet të jetë më i domosdoshëm përmirësimi gjendjes, dhe nganjëherë siguri, së rrjetit rrugor ekzistues.** Faktikisht, rrugët pyjore dhe blegtorale degradohen rregullisht nga reshjet e mëdha të shiut në vjeshtë dhe dimër, të cilat krijojnë vatra për erozion dhe mbushje. Sidoqoftë, interesi i tyre përtej pylltarisë dhe fshatarësisë dihet se siguron një mbërritshmëri më të mirë në vlerat peizazhiste dhe rekreative

## VI.2 Struktura të tjera dhe përdorimet e tokës

Për të përfunduar përmbledhjen mbi strukturat e tjera dhe përdorimet e tokës, duket e dobishme të ilustrimet me pajisjet e vaditjes dhe furnizimit me ujë, duke pasur parasysh se nuk ka infrastrukture ose objekte shtesë të rëndësishme në lidhje me kullotat dhe pyjet. Sa i përket kullotave, mund të shtohet se **infrastruktura për bagëtinë** përfaqësohet nga lerat, kasollet, si dhe stanet dhe gardhet e ndërtuara për strehimin e bagëtive dhe barinjve gjatë verës.

**Në lidhje me vaditjen**, jepet situata e përgjithshme në bashkinë e Gramshit edhe pse nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me EP Rove, por mund ta prekë atë indirekt. Sistemi ekzistues i vaditjes konsiston në rezervuarët ujëmbledhës dhe rrjetin shpërndarës të kanaleve vaditës, i cili pavarësisht dëmtimeve të ndodhura përgjatë viteve (kryesisht në rrjetin e pompave elektrike, vjetërsimit të tubacioneve dhe amortizimit të kanaleve), është përgjithësisht funksional në një pjesë të madhe të tij. Strukturat kryesore të vaditjes të bashkisë janë: Liqeni i Teqes së Dushkut (Snosëm), kanali vaditës Poroçan (Hotomi), kanali vaditës Kurate (Grabovë e Poshtme), rezervuari i Galigatit, Rezervuarët Dardhë 1 dhe 2, kanali vaditës i Valamarës. Ekzistojnë pajisje të tjera të vogla për vaditje për tokën bujqësore, nga burimet e ujit dhe/ose falë pompave elektrike.


**Infrastruktura e furnizimit me ujë**nga rrjeti Kërpicë – Gramsh mund të jepet në nivelin e EP Rove (të dhënat e siguruar nga bashkia).

## VII. Analizimi i të dhënave për pyjet dhe kullotat

### VII.1 Analizimi i të dhënave për pyjet

#### VII.1.1 Analizimi i tipeve pyjore

Pyjet luajnë një rol të rëndësishëm në nivel bashkie dhe japin kontributin kryesor në produktet drusore dhe jodrusore. Gjatë inventarizimit në terren kemi vërejtur se burimet pyjore janë mbishfrytëzuar gjatë periudhës së ndërmjetme midis dy planeve të mbarështrimit, pasi 12.4 % e sipërfaqes pyjore ka një kurorëndësi të ulët (0.3 – 0.5) dhe 62.6% ka kurorëndësi nga 0.6 deri 0.8.



Volumi mesatar për hektar (trungishte) në nivel ekonomie pyjore arrin 139.1 m<sup>3</sup>/ha, volumi i përgjithshëm 263667.3 m<sup>3</sup> dhe rritja mesatare vjetore 4.17 m<sup>3</sup>/ha/vit. Vlera e ulët e volumit mesatar për 1 hektar tregon që indeksi i stacionit dhe këto burime pyjore janë përdorur në mënyrë intensive dhe prania e grumbujve të rinj ose të pjekur tregon nevojën e tyre për ndëryrje silvikulturore dhe masa shtesë për rimëkëmbjen e sipërfaqeve pyjore të degraduara. Më poshtë paraqiten rezultatet e analizimit për tipet kryesore të pyjeve të identifikuar gjatë matjeve në secilën parcelë pyjore dhe të dhënat dendrometrike përkatëse.

**Të gjitha të dhënat e hollësishme për çdo parcelë dhe n/parcelëdhe sipas tipeve pyjore jepen në shtojcën 2.**

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)


### VII.1.2 Ndarja e sipërfaqes dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes

Një tjetër aspekt i studimit ka qenë ndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit sipas regjimit të qeverisjes. Ndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit siç kërkohet nga udhëzuesi paraqitet në tabelat më poshtë për secilën formë qeverisjeje.



Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m <sup>3</sup> /ha)	Volumi i përgjithshëm në këmbë (m <sup>3</sup> )
Trungishte	1894.9	139.1	263667.3
Cungishte			
Shkurre			
<b>Gjithsej</b>	<b>1894.9</b>		<b>263667.3</b>

### VII.1.3 Struktura e pyjeve sipas klasave të moshës dhe klasave të prodhimitarisë së stacionit

Klasa e prodhimit u përcaktua vetëm për speciet kryesore, për të cilat ekzistojnë tabelat e prodhimit. Nga vlerësimet rezultoi që 40.1% e sipërfaqes pyjore i përket klasës së IV-t dhe të V-të të prodhimit, gjë që tregon se grumbujt pyjorë me prodhimtari të ulët janë mbizotërues në EP Rove.



Përveç kësaj, ne studiuam gjithashtu edhe ndarjen e sipërfaqes pyjore dhe volumit në këmbë sipas klasave të moshës për secilin regjim qeverisjeje dhe grafiqet paraqiten më poshtë.




Në rastin e trungishteve, 69 % e sipërfaqes janë grumbuj pyjorë të rinj, me moshë nga 1 deri 40 vjeçare dhe 22% janë grumbuj pyjorë të pjekur. Grumbujt pyjorë të moçëm zënë 2.7% të sipërfaqes së pyjeve dhe do i nënshtrohen prerjeve të njepasnjeshme uniforme.

#### Sipërfaqja në ha sipas specieve dhe klasave të moshës

Në pyjet trungishte, ahu është specia mbizotëruese, duke zënë 91% të sipërfaqes, ndjekur nga bredhi i bardhe (5%) dhe Pisha e zeze (3.3%), ndërsa speciet më pak të përhapura janë Panja fletgjere dhe Pisha e detit (0.01%).

Klasa e Moshes	Siperfaqja sipas specieve								Siperfaqja totale(ha)
	AH	AHM	BRB	PAG	PAM	PIB	PIZP	ROB	
0-20	312.6	4.4	24.7		8.6		0.1		350.4
21-40	910.25	0.3	45.5		2.1		0.2	2.3	960.7
41-60	368.6	0.4	19.9	0.2	0.6		33.1		422.8
61-80	66.9	0.7	15		2.1	0.2	25.1		110.0
81-100	39.4		1.1		5		0	0.2	45.7
101-120			3.6				1.7		5.3
<b>Totali (ha)</b>	<b>1697.75</b>	<b>5.8</b>	<b>109.8</b>	<b>0.2</b>	<b>18.4</b>	<b>0.2</b>	<b>60.2</b>	<b>2.5</b>	<b>1894.9</b>



#### Volumi i specieve sipas klasave të moshës


Në studimin e shpërndarjes së volumit të specieve mbizotëruese sipas klasave të moshës, gjetëm që në rastin e trungishteve, Ahu ka volumin më të madh dhe Panja ka vlerën më të ulët. Volumi më i madh sipas klasave të moshës u gjet t'u përkasë klasës së moshës nga 21-40 vjeçare(50.4%) dhe volumi më i ulët, në klasën e moshës 101-120 vjeçare..

Klasa e Moshes	Volumi ne kembe(m3) sipas specieve									Volumi total(m3)
	AH	AHM	ASH	BRB	PAG	PAM	PIB	PIZP	ROB	
0-20	17268.83		49.2	686.55		17.72		26.25		18048.55
21-40	131412.926	0.5		1551.4		8.012		13.56	8.4	132994.80
41-60	66223	60.72		998.196	49.44	71.65		342.49		67745.50
61-80	22907	0.2		1458.5		183.85	63.42	2598.6		27211.57
81-100	17437.1			94		33.6		0	1.8	17566.50
101-120				86.6				13.8		100.40
<b>Totali (m3)</b>	<b>255248.856</b>	<b>61.42</b>	<b>49.2</b>	<b>4875.246</b>	<b>49.44</b>	<b>314.832</b>	<b>63.42</b>	<b>2994.7</b>	<b>10.2</b>	<b>263667.31</b>

Formatted: Italian (Italy)

#### Pyjet Trungishte

Shpërndarja e sipërfaqes sipas klasave të moshës në pyjet trungishte ka një shpërndarje normale, duke e arritur pikun në klasën e moshës 21-40 vjeçare për sipërfaqen dhe volumin në këmbë. Klasat e ekstremeve të moshës kanë vlerat më të ulëta të sipërfaqes pyjore dhe volumit. Këto shifra tregojnë që në pyjet trungishte në EP Rove duhet të kryhen trajtime me rrallime silvikulturore me intensitete të ndryshme për menaxhimin e tyre. Për grumbujt pyjorë më të vjetër, në EP Rove do të aplikohen prerje farore pasi e kanë tejkaluar moshën e shfrytëzueshmërisë.



Volumi i përgjithshëm sipas klasave të prodhimit u llogarit për pyjet trungishte. Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e vëllimit sipas klasave të prodhimit. Gjetëm që 46% e vëllimit të përgjithshëm i përket klasës së III-të të prodhimit dhe 24% dhe 21% e vëllimit të përgjithshëm në këmbë u klasifikuan përkatësisht në klasën e IV-t dhe të V-të të prodhimit. Nxjerrim përfundimin që në përgjithësi në EP Rove mbizotërojnë pyjet me prodhimtari të ulët dhe kjo për shkak të keqmenaxhimit të pyjeve trungishte.

Klasa e prodhimit	Volumi në këmbë(m <sup>3</sup> )	%
I		
II	23730.06	9.00%
III	121286.96	46.00%
IV	63280.15	24.00%
V	55370.14	21.00%
Gjithsej	263667.31	100.00%

#### Sipërfaqja pyjore sipas specieve kundrejt klasës së prodhimit

Një aspekt tjetër i studimit ishte ndarja e sipërfaqes pyjore sipas specieve kundrejt prodhimtarisë. Nga tabela e mëposhtme arritëm në përfundimin që 41% e sipërfaqes pyjore ka prodhimtari të ulët, pasi bëjnë pjesë në klasën e IV-t dhe të V-të të prodhimit.


Speciet	Sipërfaqja sipas klasave të prodhimit (ha)					Sipërfaqja gjithsej (ha)
	I	II	III	IV	V	
AH		359.7	671.1	379.3	287.7	<b>1697.8</b>
AHM				5.5	0.3	<b>5.8</b>
BRB			60.1	25.6	24.1	<b>109.8</b>
PAG					0.2	<b>0.2</b>
PAM			1.8	10	6.6	<b>18.4</b>
PIZP		8	29.5	15.5	7.2	<b>60.2</b>
PIB					0.2	<b>0.2</b>
ROB				1.8	0.7	<b>2.5</b>
<b>Gjithsej</b>	<b>0</b>	<b>367.7</b>	<b>762.5</b>	<b>437.7</b>	<b>327</b>	<b>1894.9</b>

## VII.2 Analizimi i të dhënave për kullotat

### VII.2.1 Gjendja e kullotave



Sipërfaqja e përgjithshme e kullotave prej 259.03 ha në EP Rove është ndarë sipas tipeve dhe shkallës sëmbulesës barishtore. Tabelat dhe grafikët më poshtë eidentojnë gjendjen mesatarisht të pasur të tokave kullosore, duke qenë se 81% e sipërfaqes kullosore ka një mbulim barishtor mbi 90% dhe pjesëmarrja e leguminozeve duket relativisht e lartë.

Tipi i kullotës	Sipërfaqja e tokës kullosore (ha)
Kullotë	222.01
Kullotë me shkurre	4.12
Kullotë me drurë	32.89
<b>TOTALI(HA)</b>	<b>259.03</b>




Shkalla e mbulimit me bimësi barishtore(%)	Sipërfaqja e tokës kullimore (ha)
< 20	3.85
60 deri 70	7.62
70 deri 80	15.23
80 deri 90	22.85
90 deri 99	30.46
100%	179.02
<b>Totali(ha)</b>	<b>259.03</b>

Rëndësia e specieve graminore dhe leguminoze jepen në grafikët e mëposhtëm. Speciet graminore kryesore janë: *Dactylis glomerata*, *Poa annua*, *Avena fatua*. Speciet leguminoze dominohen nga: *Trifolium scabrum*, *Trifolium repens*, *Trifolium pratense*, *Trifolium campestre*, *Vicia grandiflora*, *Medicago minima*. Specie të tjera barishtore janë të ndryshme si *Bellis perennis*, *Plantago sp.*, *Micromeria juliana*, etj.



Sikurse përshkruhet në seksionet e mësipërme, erozioni paraqet një kufizim serioz për kullotjen. Një kufizim tjetër është prania e gurëve, siç evidentohet më poshtë.

Shkalla e mbulimit me gurë	Sipërfaqja e tokës kullimore (ha)
E ulët < 30%	73.1
E moderuar 31-60%	144.3
E lartë > 60%	41.9
<b>Totali (ha)</b>	<b>259.3</b>



Lidhur me presionin mbi sipërfaqen kullimore dhe mbulimin e kufizuar me vegjetacion, përparësi është funksioni mbrojtës ndaj atij prodhues.


### VII.2.2 Madhësia dhe vendndodhja e sipërfaqes kullimore

Saktësimet mbi sipërfaqen kullimore në parcela dhe n/parcela, vendndodhjen e tyre, duke iu referuar qytetit/fshatit kryesor dhe përdorimin e tyre (kryesisht të përbashkët) jepen në tabelën dhe hartën vijuese.


Parcela	N/parcela	Sipërfaqja (ha)	Njësia administrative	Mënyra e përdorimit
1	c	17.5	Kukur	Përbashkët
1	c	30.4	Kukur	Përbashkët
2	b	3.0	Kukur	Përbashkët
2	c	11.2	Kukur	Përbashkët
3	b	12.3	Kukur	Përbashkët
6	b	14.9	Kukur	
9	b	2.4	Kukur	Përbashkët

<b>Parcela</b>	<b>N/parcela</b>	<b>Sipërfaqj (ha)</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Mënyra e përdorimit</b>
10	c	2.4	Kukur	Përbashkët
12	b	3.9	Kukur	Përbashkët
13	b	10.0	Kukur	Përbashkët
14	b	2.5	Kukur	Përbashkët
15	b	0.8	Kukur	Përbashkët
16	b	1.0	Kukur	Përbashkët
16	b	0.7	Kukur	Përbashkët
16	c	1.6	Kukur	Përbashkët
16	f	2.7	Kukur	Përbashkët
17	b	8.5	Kukur	Përbashkët
17	c	4.5	Kukur	Përbashkët
17	c	7.3	Kukur	Përbashkët
17	d	2.8	Kukur	Përbashkët
17	e	3.0	Kukur	Përbashkët
18	b	6.0	Kukur	Përbashkët
19	b	16.6	Kukur	Përbashkët
19	c	31.4	Kukur	Përbashkët
19	c	7.1	Kukur	
20	b	21.9	Kukur	Përbashkët
22	d	5.0	Kukur	Përbashkët
24	c	2.5	Kukur	Përbashkët
25	b	2.4	Kukur	Përbashkët
26	b	1.7	Kukur	Përbashkët
27	b	4.8	Kukur	Përbashkët
27	c	4.7	Kukur	Përbashkët
29	b	4.0	Kukur	Përbashkët
30	b	6.9	Kukur	Përbashkët
31	d	7.0	Kukur	Përbashkët
32	d	1.6	Kukur	Përbashkët
35	c	1.2	Kukur	Përbashkët
36	b	6.9	Kukur	Përbashkët
37	c	2.9	Kukur	Përbashkët
38	c	11.0	Kukur	Përbashkët

### Administrative unit: Rove 1






### Administrative unit: Rove 2



### VII.2.3 Altituda, pjerrësia, kundrejtimi dhe kushtet hidrologjike

Hartet dhe tabelat e mëposhtme paraqesin analizën lidhur me lartësinë mbi nivelin e detit, pjerrësinë dhe kundrejtimin në mënyrë të përgjithshme për secilën parcelë që përdoret për kullotë.





Parcela	Sipërfaqja (ha)	Pjerrësia minimale (gradë)	Pjerrësia maksimale (gradë)	Pjerrësia mesatare (gradë)
01c	48.0	2.3	37.2	21.4
02b	2.9	11.7	22.2	17.2
02c	10.6	12.3	25.8	20.2
03b	12.2	12.4	38.8	22.8
06b	15.2	11.5	36.2	26.0
09b	2.3	2.6	28.9	17.5
10c	2.5	2.5	26.5	18.1
12b	3.3	0.4	35.4	20.8
13b	9.5	7.7	34.2	19.4
14b	2.2	7.5	36.0	23.0
15b	0.5	8.2	18.4	12.9
16b	1.6	5.9	24.9	19.8
16c	1.8	17.7	24.7	22.1
16f	2.8	3.4	17.7	8.3
17b	8.1	3.8	37.0	20.1
17c	11.6	8.5	27.7	17.5
17d	2.8	3.6	12.8	8.4
17e	3.2	2.9	14.4	10.0
18b	5.2	9.6	33.7	20.7
19b	14.6	0.5	32.6	11.4
19c	38.5	0.1	29.1	10.7
20b	21.5	1.9	29.3	13.2
22d	4.4	5.4	24.3	15.6
24c	2.4	7.0	14.5	10.2
25b	2.3	15.7	23.0	19.9
26b	1.9	9.1	21.3	18.3
27b	4.3	0.3	19.7	11.1
27c	3.7	2.4	10.2	6.9
29b	4.2	3.3	22.4	11.7
30b	5.9	3.2	29.3	14.5
31d	6.7	4.1	25.6	15.8
32d	1.5	2.1	22.3	13.1
35c	1.3	2.2	14.0	6.8
36b	6.7	4.9	21.1	12.2
37c	3.2	3.6	20.6	14.8
38c	10.6	3.8	22.6	13.4

Parcela	N/parcela	Sipërfaqja provë	Kundrejtimi kryesor
1	c	28	Juglindor
1	c	433	Verilindor
2	b	17	Juglindor
2	c	418	Juglindor
3	b	387	Juglindor
6	b	422	Jugperëndimor
9	b	338	Juglindor
10	c	339	Juglindor
12	b	319	Jugperëndimor
13	b	341	Perëndimor
14	b	375	Verilindor
15	b	386	Veriperëndimor
16	b	205	Perëndimor
16	b	395	Jugperëndimor
16	c	209	Perëndimor
16	f	128	Jugperëndimor
17	b	385	Jugperëndimor
17	c	210	Perëndimor
17	c	211	Perëndimor
17	d	109	Juglindor
17	e	100	Verior
18	b	399	Juglindor
19	b	459	Jugperëndimor
19	c	83	Verior
19	c	445	Jugperëndimor
20	b	457	Jugperëndimor
22	d	99	Juglindor
24	c	174	Veriperëndimor
25	b	470	Veriperëndimor
26	b	475	Veriperëndimor
27	b	483	Veriperëndimor
27	c	160	Veriperëndimor
29	b	489	Jugperëndimor
30	b	494	Jugperëndimor
31	d	301	Perëndimor
32	d	318	Verilindor
35	c	361	Jugperëndimor
36	b	343	Verilindor
37	c	317	Veriperëndimor
38	c	323	Verior

Në drejtim të rrjetit hidrologjik, krahas përrrenjve të treguar në hartë në seksionin IV.5, ka edhe disa lera, të cilat u shërbejnë bagëtive për të pirë ujë.



*Pamje e një lere për bagëtitë në bashkinë Gramsh*

#### **VII.2.4 Mbërritshmëria**

Sipërfaqet kullosore ndodhen kryesisht në pjesën lindore të EP Rove në altitudat më të mëdha. Duhet të risillet edhe njëherë ndërmend që rrjeti rrugor është në gjendje të degraduar. Megjithatë, kullotat janë lehtësisht të mbërritshme, të paktën nëpër shtigjet këmbësore dhe për ato që ndodhen në afërsi të tokave bujqësore mund të mbërrihen me automjete.

#### **VII.2.5 Mbledhja e të dhënave për sipërfaqet e djegura në kullota**

Duke iu referuar të dhënave të siguruar nga Bashkia dhe si rezultat i anketimit në fshatra, duket që djegia e kullotave nuk është një praktikë që zbatohet në EP Rove.

## VIII. Rezultatet e inventarizimit të pyjeve dhe kullotave

### VIII.1 Rezultati i inventarizimit në pyje

#### VIII.1.1 Analiza statistikore e inventarizimit të pyjeve

Inventarizimi i EP Rove u krye gjatë periudhës Dhjetor 2020 deri në Maj 2021 (për shkak të reshjeve të dëborës gjatë dimrit dhe pranverës). Ai u bazua në matjet sistematike në sipërfaqet provë të përhershme dhe të përkohshme për shkak se ka avantazhe jo vetëm në aspektin e saktësisë, por gjithashtu në vlerësimin e ndryshimit të të dhënave në pyje nëpërmjet krahasimit midis inventarizimeve të njëpasnjëshëm. Gjithsej u matën 515 sipërfaqe provë, ku 83% e totalit të sipërfaqeve provë u morën në pyje (trungishte, cungishte) dhe 17% në sipërfaqe me bimësi pyjore.

Përdorimi i tokës	Nr. i sipërfaqeve provë
Pyll	430
Kullotë	69
Sipërfaqe me bimësi pyjore	16
E pambërritshme	2
<b>Gjithsej</b>	<b>517</b>

Inventarizimi i pyjeve u krye në ndërthurje me ortofotot me rezolucion të lartë si një mjet për ndërtimin e rrjetit dhe shpërndarjes së sipërfaqeve provë. Përveç kësaj, vendndodhjet e sipërfaqeve provë u përcaktuan gjithashtu edhe në hartat topografike, të cilat së bashku me ortofotot u përdorën nga ekipet e terrenit për të kompletuar inventarizimin. Metodologjia e përdorur për ngritjen e rrjetit të sipërfaqeve provë ishte e njëjtë me atë të specifikuar në Udhëzuesin e PMPK të vitit 2019. Matjet u kryen në tre rrrathë bashkëqendrorë në sipërfaqet provë, me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup>, 200 m<sup>2</sup> dhe 400 m<sup>2</sup>, në mënyrë që të përfshiheshin të gjitha kategoritë diametrike të drurëve (1.3 m nga toka) në grumbujt pyjorë. Në sipërfaqen provë 25 m<sup>2</sup> u mblodhën të dhëna për ripërtëritjen natyrore dhe u matën drurët, diametri bazimetrik i të cilëve ishte nga 2 cm deri 7.5 cm. Sipërfaqet provë me këtë madhësi, u përdorën gjithashtu edhe për inventarizimin e kullotave dhe në vlerësimin e prodhimeve pyjore jodrusore. Në sipërfaqen e dytë provë (200 m<sup>2</sup>) u matën drurët me diametër bazimetrik nga 7.51 cm deri 27.5 cm dhe në sipërfaqen e tretë provë (400 m<sup>2</sup>) u matën vetëm drurët me diametër më të madh se 27.5 cm.

Për të vlerësuar saktësinë e inventarizimit të pyjeve bazuar në volumin e përlogaritur për secilën sipërfaqe provë, ne vlerësua parametrat e mëposhtëm:

- Shmangia standard e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_x = \pm \sqrt{S_x^2}$$
$$S_x^2 = \frac{\sum_{i=1}^n x_i^2 - \frac{(\sum_{i=1}^n x_i)^2}{n}}{n-1}$$

- Koefficienti i variacionit të volumit ndërmjet sipërfaqeve provë;

$$S_{x\%} = \frac{S_x}{x} \cdot 100$$

- Gabimi standard në metër kub dhe përqindje;

$$S_{\bar{x}} = \frac{S_x}{\sqrt{n}}$$

Bazuar në këto ekuacione ne vlerësuam saktësinë e volumit ndërmjet sipërfaqeve provë dhe gjetëm që gabimi standard në llogaritjen e volumit ishte 5.9%. Ky gabim është jodomethënës, që do të thotë se të dhënat e volumit të siguruar nga inventarizimi në terren janë brenda kufirit të gabimit ( $\pm 20\%$ ).

Numri i sipërfaqeve provë	515
Volumi mesatar i sipërfaqeve provë (m <sup>3</sup> /ha)	102.8
Shmangia standard	139.3
Koefficienti i variacionit	135
Gabimi standard (m <sup>3</sup> )	6.1
Gabimi standard (%)	5.9

### VIII.1.2 Volumi në këmbë dhe rritja e grumbujve pyjorë

Rezultatet e inventarizimit të pyjeve treguan që sipërfaqja pyjore e EP Rove është 1894.9 ha. Volumi në këmbë në EP Rove është 263667.3 m<sup>3</sup>, ekuivalent me 139.1 m<sup>3</sup>/ha.

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Volumi mesatar (m <sup>3</sup> /ha)	Volumi i përgjithshëm në këmbë (m <sup>3</sup> )	Rritja mesatare vjetore (m <sup>3</sup> /ha/vit)
Trungishte	1894.9	139.1	263667.3	4.17
<b>Gjithsej</b>	<b>1894.9</b>	<b>139.1</b>	<b>263667.3</b>	<b>4.17</b>

Krahas kësaj, ne vlerësuam volumin e asortimenteve për pyjet. Nga vlerësimet rezultoi që lënda e hollë është asortimenti drusor kryesor dhe zë 56.8%, ndjekur nga drutë e zjarrit me 38.5%, lënda e mesme me 4.0%, lënda e trashë me 0.1% dhe mbeturina 0.6%. Shpërndarja e asortimenteve drusore tregon që nga burimet pyjore në EP Rove mund të prodhohen asortimente drusore me dimensione të vogla.

Forma e Menaxhimit	Volumi i përgjithshëm në këmbë (m <sup>3</sup> )	Volumi drusor sipas asortimenteve (m <sup>3</sup> )				
		Lëndë e trashë	Lëndë e mesme	Lëndë e hollë	Dru zjarri	Mbeturina
Trungishte	263667.31	215	10664.1	149710.6	101553.2	1524.4
<b>Gjithsej</b>	<b>263667.31</b>	<b>215</b>	<b>10664.1</b>	<b>149710.6</b>	<b>101553.2</b>	<b>1524.4</b>

Formatted: Italian (Italy)

Formatted: Italian (Italy)

Bazuar në mostrat e drurëve të marrë brenda sipërfaqeve provë me anë të tyrielës, u bë matja e rritjes së drurëve për 10 vitet e fundit. Rezultatet e rritjes mesatare vjetore për 1 ha në nivel ekonomie pyjore rezultoi 4.17 m<sup>3</sup>/ha/vit, ndërsa rritja vjetore për të gjithë ekonominë ishte 7903.1 m<sup>3</sup>/vit.

Regjimi i qeverisjes	Sipërfaqja (ha)	Rritja mesatare vjetore (m <sup>3</sup> /ha/vit)	Rritja e përgjithshme vjetore (m <sup>3</sup> )
Trungishte	1894.9	4.17	7903.1
Cungishte			
Shkurre			
<b>Gjithsej</b>	<b>1894.9</b>	<b>4.17</b>	<b>7903.1</b>

### VIII.1.3 Struktura vertikale

Bazuar në të dhënat e regjistruara nga ekipet e terrenit ne vlerësuam shpërndarjen e strukturës vertikale sipas parcelave pyjore (shih tabelën e mëposhtme). Vërejtëm që në71% të sipërfaqeve provë, grumbujt pyjorë kanë strukturë vertikale me dy kate, në27% kanë strukturë vertikale të thjeshtënjëkatëshe dhe vetëm në1.4% kanë strukturë shumëkatëshe.

Struktura vertikale	Nr. i parcelave	%
Njëkatëshe	40	27.2%
Dykatëshe	105	71.4%
Shumëkatëshe	2	1.4%
<b>Gjithsej</b>	<b>147</b>	<b>100.0%</b>

Klasifikimi i grumbujve pyjorë sipas strukturës vertikale jepet hollësisht në shtojcën 3.

### VIII.1.4 Cilësia e lëndës drusore në këmbë

Vlerësimi racional dhe kompleks i lëndës drusore kërkon njohuri të hollësishme të cilësisë së grumbujve pyjorë, jo vetëm në drejtim të volumit të përgjithshëm, por gjithashtu edhe në drejtim të vlerësimit të asortimenteve. Ky klasifikim është realizuar nga raporti i volumit të drurëve ekuivalentë me klasën e parë të cilësisë ndaj volumit të përgjithshëm. Kjo hipotezë vërtetohet kur kemi parasysht vetëm drurët e kategorisë së diametrave qendrorë, të cilët kanë peshën më të madhe në vëllimin e përgjithshëm të grumbujve pyjorë. Megjithatë nuk ka ndonjë vlerësim të cilësisë nga ekipet e inventarizimit në terren, në

vlerësimin e cilësisë në bazohemi në raportin e lëndës së punimit dhe druve të zjarrit ndaj volumit të përgjithshëm bazuar në tabelën e mëposhtme:

Klasa e cilesise	Kriteret e percaktimit
3	<b>Lenda e punimit ze me pak se 60% te volumit per haloret dhe 30% per fletoret.</b> <i>(dru zjarri (trung me cilesi te dobet dhe nuk perdoret per qellim industrial) (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore &lt; 10%; fletore &lt; 10%). Ne kete rast lenda e punimit ze 15% te volumit kurse drute e zjarrit 85% te volumit).</i>
2	<b>Lenda e punimit ze 61 - 80 % te volumit per haloret dhe 30 - 50 % per fletoret.</b> <i>(trungu ka nje gjatesi nga 2 deri ne 6 m (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore &gt;10- 60% (83% lende punimi+17% dru zjarri); fletore &gt; 10-50% (64% lende punimi + 36% dru zjarri).</i>
1	<b>Lenda e punimit ze &gt; 80 % te volumit per haloret dhe &gt; 50 % per fletoret.</b> <i>(Eshte i cilesise se mire dhe ka nje gjatesi minimale prej 6 m (perqindja e lendes se punimit kundrejt gjatesise totale sipas specieve eshte: halore &gt; 60% (98% lende punimi + 2 % dru zjarri; fletore &gt; 50% (83% lende punimi + 17% dru zjarri).</i>

Formatted: German (Switzerland)

Bazuar në raportin e volumit të lëndës së punimit ndaj volumit të përgjithshëm, duke iu referuar tabelës së mësipërme në bëmë vlerësimin e përqindjes së secilit asortimenteve për secilin ngaster dhe me pas logaritëm volumnin e asortimenteve sipas fletoreve dhe haloreve.

Asortimentet	Fletore		Halore	
	Volumi(m3)	%	Volumi(m3)	%
L.trashe	206.6	0.1%	8.4	0.1%
L.mesme	10527.6	4.1%	136.5	1.6%
L.Holle	145141.3	56.8%	4569.3	55.2%
Dr.Zjarri	99510.2	39.0%	2043	24.7%
Mbeturina			1524.4	18.4%
	<b>255385.7</b>		<b>8281.6</b>	

Vlerësimet tona treguan që grumbujt pyjorë fletore në EP Rove i përkasin klasës së II-të të cilësisë pasi lenda e punimit ze 61% dhe drute e zjarrit 38.5%. E njejta gje u konstatua edhe në rastin e grumbujve me halore ku lenda e punimit zuri 57% dhe drute e zjarrit 25% dhe sipas klasifikimit të mesipërme këta grumbuj bëjnë pjesë në klasën e 1-re të cilësisë. Por ky vlerësim nuk është ende i mjaftueshëm, pasi

duhet të shoqërohet gjithashtu edhe me vlerësimin e lëndës drusore me fokus kryesor tek anomali të, plagët, nyjet, etj.

### VIII.1.5 Biomasa dhe faktorët e ekspansionit të biomasës (BEF)

Pyjet dhe shkurret në EP Rove luajnë një rol të rëndësishëm në sekuestrimin e karbonit. Për llogaritjen e biomasës mbitokësore ne përdorëm të dhënat e volumit të siguruara nga inventarizimi në terren dhe për t'i konvertuar në peshë të thatë përdorëm të dhënat e dendësisë nga Udhëzuesi i Panelit për Ndryshimet Klimatike (Panel for Climate Change) për speciet kryesore dhe për secilin regjim qeverisje:

- Ahun për pyjet trungishte
- Lisin për pyjet cungishte
- Marenë për shkurret

Përmbajtja e karbonit në peshën e thatë të biomasës u konsiderua 0.5. Konvertimi nga C në CO<sub>2</sub> u bë duke u bazuar në peshën molekulare (CO<sub>2</sub>/C = 44/12 = 3.667).

Për llogaritjen e biomasës mbitokësore përdorëm ekuacionin e mëposhtëm:

$$B_{mbt} = V_{total} \times D_d \times C_{ratio} \times BEF$$

ku:

V<sub>total</sub> – volumi i përgjithshëm për secilin regjim qeverisje

D<sub>d</sub> – dendësia e peshës së thatë

C<sub>ratio</sub> – përmbajtja e karbonit në biomasën e thatë (0.5)

BEF\_Faktori i ekspansionit të biomasës

Regjimi i qeverisjes	Sip. (ha)	Volumi (m <sup>3</sup> )	Dendësia bazë e drurit (kg/m <sup>3</sup> )	Peshë e thatë (ton)	BEF	Biomasa mbi tokësore (ton)	Pesha e C (ton)	Pesha e CO <sub>2</sub> (ton)
Trungishte	1894.9	263667.3	800	210933.	1.15	242573.	121287	445123.2
<b>Gjithsej</b>	<b>1894.9</b>	<b>263667.3</b>		<b>210933.</b>		<b>242573.</b>	<b>121287</b>	<b>445123.2</b>

### VIII.1.6 Analiza e rolit të ekonomisë pyjore në sekuestrimin e Karbonit

EP Rove ka një sipërfaqe prej 1894.9 ha dhe burime të këtilla luajnë një rol të rëndësishëm në sekuestrimin e karbonit. Bazuar në të dhënat nga inventarizimi i pyjeve, sasia e CO<sub>2</sub> të sekuestruar nga burimet pyjore në EP Rove rezultoi 445123.2 ton. Nëse marrim parasysh rritjen mesatare vjetore të pyjeve (7903 m<sup>3</sup>/year), sasia e CO<sub>2</sub> që depozitohet çdo vit është 13342 ton. Kjo sasi pritej të ishte më e lartë nëse burimet pyjore në EP Rove do mbarështroheshin në mënyrë të qëndrueshme. Të gjitha prerjet e paligjshme dhe lënda drusore e djegur nga zjarret në pyje konsiderohen si rrjedhje, prandaj për këto arsye CO<sub>2</sub> aktual i depozituar është më i ulët se sa kapaciteti depozitues natyral. Megjithatë kjo EP ka një

Formatted: Albanian

sipërfaqe të vogël pyjesh, këto burime pyjore luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale dhe ofrojnë shumë shërbime mjedisore, siç janë sekuestrimi i karbonit, qarkullimi i elementëve ushqyes, mbajtja e ujit, cilësia dhe strehimi i kafshëve, etj.

## VIII.2 Gjendja shëndetësore/fitosanitare

Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare e grumbujve pyjorë përgjithësisht vlerësohet të jetë e mirë. Pavarësisht pranisë së procesionares, e cila është shtuar gjatë viteve të fundit, dhe disa sulmeve tek drurët gjetherënës (tharje e pjesshme e shkaktuar nga *Cydalima perspectalis*) **nuk ka shenja të ndikimeve masive të patogjenëve, të cilët zvogëlojnë rritjen apo çojnë deri në zhdukjen në nivel të grumbujve pyjorë.**

Gjithashtu theksohet që **nuk ka raste domethënëse të vëzhgimeve të tharjes së drurëve për shkak të ndryshimeve klimatike dhe përsëritjes së thatësirave, megjithëse grumbujt pyjorë do të ekspozohen veçanërisht në të ardhmen**, duke marrë në konsideratë kushtet specifike të EP Rove, të karakterizuara nga njëndryshueshmëri e madhe e altitudës, kundrejtimit dhe klimës. Prandaj mund të thuhet që dëmet kryesore janë shkaktuar nga burime të tjera: mbikullotja, zjarret në pyje, prerjet e paligjshme, erozioni.

### VIII.2.1 Drurët e tharë

Drurët e tharë janë kryesisht si pasojë e zjarreve në pyje, mbikullotjes ose krasitjes së tepruar për sigurimin e gjethit për bagëtitë.

Në lidhje me të dhënat e mbledhura rreth ngjarjes së zjarreve në pyje, parcelat më të prekura dhe karakteristikat e tyre jepen më poshtë.

Parcelat e prekura	Sipërfaqja e djegur(ha)	Speciet e prekura	Viti i zjarrit në pyje
1 b	5	Ah	2014
6 b	5	Ah	2014
10 a	25	Ah	2020
11 a	2	Ah	2018
28 a	2	Ah	2018



*Ilustrim i ngjarjes së zjarreve në EP Rove*

### VIII.2.2 Dëmtime të tjera

Duke iu referuar rubrikës “dëmtimet” lidhur me të dhënat e grumbulluara gjatë inventarizimit, të cilat janë të lidhura me ato të rubrikës “rreziku për biodiversitetin” (shih pjesën V.8 për saktësim), janë dhënë rezultate të përgjithshme. Më tepër se 72% e dëmtimeve kanë si shkaktar erozionin dhe dëborën, ndërsa prerjet e paligjshme, shpyllëzimet dhe mbikullotja janë shkaqet e tjera të dëmtimeve.

Shkaku i dëmtimit	% e sipërfaqes së inventarizuar me dëme	Intensiteti mesatar i dëmit
Erozioni	36%	Të gjitha sipërfaqet provë me më pak se 25%
Dëbora	36%	Të gjitha sipërfaqet provë me më pak se 5%
Prerje e paligjshme	12%	Të gjitha sipërfaqet provë me më pak se 25%
Shpyllëzimi	9%	Gjysma e sipërfaqeve provë me më shumë se 50%
Mbikullotja	6%	Të gjitha sipërfaqet provë me më pak se 5%



*Foto ilustruese e dëmtimit nga zjarri dhe prerjet e paligjshme në EP Rove*

Në rastet më të rënda të erozionit intensiv apo djegies së pyjeve, **ndikimet mund të vënë në pikëpyetje kapacitetin e ekosistemit për të mbajtur veten në të ardhmen**ë statusin e pyllit ose kullotës dhe ofrimin e shërbimeve shoqërisë (përfshirë shërbimet mjedisore dhe sociale dhe mbrojtjen ndaj rreziqeve natyrore në zonat malore).

**Kjo është arsyeja se pse zhvillimi i funksionit mbrojtës të ekosistemeve pyjore dhe kullimore është një nga qëllimet kryesore të këtij plani mbarështrimi**, në përputhje me objektivat e tjerë kryesorë, siç janë rritja e sasisë dhe cilësisë së kapitalit të lëndës drusore në pyje.

### VIII.3 Prerjet e paligjshme

Siç është përmendur më sipër, prerjet e paligjshme përfaqësojnë shkakun e tretë të dëmeve të vëzhguara në parcela pas erozionit dhe dëborës. **Në përgjithësi, si në të gjithë vendin dhe në të gjitha ekonomitë pyjore në studim, ky fenomen ndodh gjerësisht. Më tepër se sa prerjet e paligjshme, janë prerjet informale që zhvillohen në të gjithë ekonominë pyjore.** Në këtë mënyrë, secila familje vepron në një sipërfaqe, ku e drejta e përdorimit i është njohur nga fshati dhe banorët veprojnë sipas mënyrës dhe njohurive të tyre, pa u këshilluar me shërbimin pyjor dhe pa realizuar kampionimin e drurëve. Në këtë mënyrë ata synojnë të presin drurët me dimensionet më të mëdha.

**Në këto rrethana, ndërhyrjet e bashkërenduara më mirë ndërmjet shërbimit pyjor dhe banorëve janë një faktor kyç për të zvogëluar shkatërrimin e shkaktuar nga këto prerje informale.** Si përparësi, fshatarët duhet të instruktohen të rrallojnë pyllin në formën e një ndërhyrje silvikulturore të përshtatshme, duke hequr drurët e thatë, të nënshtuarit dhe të shtrembërit. Presioni mbi burimet

pyjore duhet, gjithashtu, të përqëndrohet në përdorimin e materialit drusor që rezulton nga prerjet silvikulturore.

Përveç kësaj, supozohet që prerjet e jashtëligjshme nga firmat shfrytëzuese mund të ndodhin herë pas here, në kundërshtim me moratoriumin e shfrytëzimit të pyjeve, edhe pse fenomeni ky i vështirë për t'u vlerësuar, përmendet të ketë pësuar rënie gjatë viteve të fundit.

**Prandaj është thelbësore që zbatimi i këtij plani mbarështrimi të pasohet nga një bashkërendim më i mirë ndërmjet aktorëve në bashki dhe nga një strategji specifike e zhvilluar për kontrollin e aktiviteteve të prerjeve në pyjeve.**



*Foto ilustruese të prerjeve të paligjshme*

## VIII.4 Rezultatet e inventarizimit të kullotave

### VIII.4.1 Tipi dhe cilësia e kullotave

Rezultatet e analizës të paraqitura në pjesët V.4 dhe VII.4 mund të përmblihen si në vijim. **Kullotat zënë një sipërfaqe prej 289 ha në EP Rove.** Ato shtrihen në vazhdimësi të sipërfaqeve pyjore dhe kanë të njëjtat kushte gjeomorfologjike si pyjet. Të gjitha kullotat janë verore, duke përfshirë sipërfaqet me drurë me mbulim barishtor që vegjetojnë nga muaji Maj deri në muajin Gusht, si edhe pas shirave që bien gjatë verës dhe vjeshtës. Terreni i këtyre sipërfaqeve ka një pjerrësi nga mesatare deri të madhe. Disa sipërfaqe përfshijnë tokat e ish kooperativave bujqësore që janë refuzuar (toka bujqësore ose pemtore që nuk përdoren aktualisht).

**Në drejtim të prodhimit, kullotat janë relativisht të pasura,** për shkak të pranisë së ulët të gurëve (43.4% e kullotave është e mbuluar nga më tepër se 60% me gurë) dhe një përbërje të mirë të specieve graminore dhe leguminoze.

**Mungesa e rregullimit dhe racionalizimit në lidhje me blegtorinë në dëmtime serioze:** mbikullotje; prani të erozionit ndonjëherë, erozion në thellësi; kullotjetë pakontrolluar në tokat pyjore ku konsumohet gjithë dhe pengohet ripërtëritja. Uji për bagëtitë është një problem për të gjithë territorin e bashkisë Gramsh dhe gjithashtu është i dukshëm për këtë ekonomi pyjore, e cila siguron furnizim dhe infrastrukturë ujore të pakët për tufat e bagëtive.



*Pamje e një kullote në EP Rove*

#### **VIII.4.2 Përdoruesit e kullotave dhe koha e përdorimit**

Pavarësisht ndryshimeve midis kullotave verore dhe dimërore, **kullotat përdoren kryesisht gjatë periudhës sëverës dhe vjeshtës, duke qenë se altituda e tyre zakonisht është mbi 1000 m.** Në pjesët më të ulta, afër fshatrave, kullotja bëhet përgjatë gjithë vitit dhe këto zona mund të cilësohen si kullota gjithëvjetore.

**Pothuajse të gjithë përdoruesit janë banorë të fshatrave në afërsi të tokave kullosore** në referencë të të drejtave të tyre të njohura zyrtarisht. Përdorimi i kullotave bëhet kryesisht në mënyrë të përbashkët, nga grup familjesh që ndodhen në afërsi të sipërfaqeve kullosore.

#### VIII.4.3 Numri aktual i blegtorisë

Shumica e kafshëve përfaqësohet nga të leshtat, të dhirtat dhe gjedhët, pasi është më i lehtë mbarështimi i këtyre llojeve, duke qenë se njerëzit kryesorë që merren me blegtori janë të moshuarit. Kullotja e dhive zakonisht është e vështirë për t'u kontrolluar, pasi shpesh është në gjendje të lirë dhe pa kufizime për t'iu afruar pyjeve. Sipas të dhënave të mbledhura në terren gjatë procesit pjesëmarrës, numri i përgjithshëm i kafshëve që kullotin në EP Rove u vlerësua të jetë **4395 krerë, ndër të cilët 3950 krerëtë imta dele dhe dhi, të cilat kullosin në pyje dhe kullota.**

Fshati	Numri i familjeve	Numri i dhenve	Numri i dhive	Numri i gjedhëve
Kukur	325	970	932	975
Gribë	175	550	502	525
Kalaj	80	245	229	240
Irmath	75	215	215	225
Vreshtas	25	60	72	75
<b>Gjithsej</b>	<b>680</b>	<b>1950</b>	<b>2040</b>	<b>445</b>

Në planin e mëparshëm të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave për periudhën 2008 – 2017, kapaciteti mbajtës i kullotave u vlerësua të ishte shumë më i ulët se sa numri aktual i bagëtive, 3 deri 4 herë më i ulët. **Ky është një faktor kryesor që shpjegon trendin e kaluar të rritjes së tokave inproduktive apo të degraduara dhe në erozionin pasues.**

Që nga kjo periudhë, si pasojë e emigrimit dhe një rënie të fortë demografike, numri i bagëtive, të cilat zakonisht vlerësohen të jenë për nevojat e banorëve ka pësuar rënie në të njëjtin raport. Në sasi, numri aktual i bagëtive ditët e sotme vlerësohet të përfaqësojë 70% të numrit të atyre që ishin në vitin 2010. **Kjo rezulton në një ulje domethënëse të presionit të kullotjes mbi burimet pyjore gjatë dekadës së fundit, megjithëse ekuilibri ndërmjet numrit të bagëtive dhe kapacitetit mbajtës është ende larg për t'u arritur.** Vlerësohet që kapaciteti mbajtës në të gjithë EP (2020 krerë të imta) është ende shumë më i ulët se sa numri aktual i bagëtive, çka nënkupton që banorët duhet të sigurojnë burime shtesë për bazën ushqimore për bagëtitë.

#### VIII.4.4 Përdorimi aktual dhe kapaciteti mbajtës i kafshëve

Parimi i përdorur për ndarjen e kullotave midis përdoruesve është “çdo fshat brenda kufijve të tij”. Së fundmi, periudha e saktë e vitit dhe mënyra e përdorimit të kullotave përcaktohen përmes vendimeve të marra nga komisionet e secilit fshat. Duke qenë se cilësia e sipërfaqeve kullosore është përgjithësisht e mirë, nga studimet e mëparshme supozohet që **kapaciteti mbajtës mesatar për 1 ha llogaritet të jetë 0.5 gjedhë, 3dhi dhe 4 dele që mund të kullotin pa i shkakuar dëme serioze pyllit apo ekosistemit.**

#### VIII.4.5 Infrastruktura aktuale

Infrastruktura kullosore është e pakët. Prania e koritave prej druri apo çezmave të ndërtuara afër burimeve që shërbejnë si rezerva ditore për pirjen normale, përveç përrrenjve sezonalë, nuk duhen

neglizhuar. Infrastruktura tjetër si zyrat, rrjeti rrugor, gardhimet, sinjalistika, shenjat treguese të ndryshme për informim gjatë sezonit të kullotjes mungojnë pothuajse plotësisht. Ekzistojnë disa leraku bagëtitë mund të pinë ujë, si edhe përrrenjtë sezonalë.



*Pellg natyror i vogël që shërben për pirje uji nga bagëtitë në EP Rove*

#### **VIII.4.6 Problemet për kullotjen dhe furnizimin me bazëushqimore për bagëtitë**

Si rezultat i seksioneve të mëparshme, edhe pse **rezerva ushqimore është e madhe se sa kapaciteti kullosor, që do të thotë një mbikullotje e përgjithshme domethënëse në pyjet dhe kullotat e EP Rove.** Ky është një shpjegim i qënësishëm i rritjes së presionit blegtoral mbi burimet pyjore dhe mbi ripërtëritjen e tyre, pasi çobenjtë kërkojnë përfurnizim me bazë ushqimore shtesë për bagëtitë që e sigurojnë nga gjethi nëpërmjet krasitjes së degëve në mënyrë të pakontrolluar. **Në zonat më tëndjeshme, masa parësore që duhet marrë është ndalimi i kullotjes nëpërmjet një kontrolli më të mirë të bagëtive ose edhe duke i rrethuar me gardhe, në mënyrë që vegjetacioni i degraduar dhe mbulesa pyjore të mund të ripërtërihet brenda 5 viteve.**

Në territorin e ekonomisë pyjore ka shenja të mbikullotjes, madje edhe të degradimit të tokës në kullota, gjithashtu dhe në sipërfaqet e pyllëzuara, të cilat së bashku me prerjet dhe tokat e varfëra janë baza e degradimit të pyjeve. Zhveshja e tokës (heqja e mbulesës barishtore dhe pyjore) ka çuar në erodimin e sipërfaqes së saj. Për këto zona rekomandohet ndërtimi i pritave malore me mur guri të thatë në përroska ose në pjesët fundore të sipërfaqeve të eroduara, pasi do të këtë efekt pozitiv në ndalimin e erozionit, ruajtjen e substancave organike dhe përmirësimin e pjellorisë së tokës.

## IX. Objektivat e planit të mbarështrimit të pyjeve dhe kullotave

### IX.1 Objektivat e përgjithshme për planifikimin afatgjatë

Konkluzionet kryesore të analizuar në seksionin e mëparshëm II.4 duhet të risillen edhe njëherë:

- Mbarështrimi i mëparshëm i pyjeve dhe kullotave, mbi të gjitha që prej vitit 1990, ka rezultuar **në njëpakësim serioz të burimeve pyjore, si në sasi ashtu edhe në cilësi**. Grumbujt pyjorë kryesisht janë të paekuilibruar me mbipërfaqësim të moshave të reja dhe kategorive të vogla diametrike, si pasojë e mbishfrytëzimit dhe prerjeve të paligjshme në dekadat e kaluara.
- **Kullotja e pakontrolluar dhe e pabashkërenduar** ka pasur një ndikim negativ në rritjen e pyjeve dhe në disa pjesë, të ripërtëritjes së tyre.
- **Tokat në pjesën më të madhe përballen me një erozion domethënës** për shkak të humbjes së vegjetacionit barishtor, mbikullotjes së pyjeve dhe pengimit të ripërtëritjes. **Në disa vende, aftësia e pyjeve për të luajtur funksionin e tyre mbrojtës në të ardhmen vihet në pikëpyetje.**

Si rrjedhim i drejtpërdrejtë, objektivi i përgjithshëm për planifikimin afatgjatë për EP Rovepërqëndrohet në tre përparësi madhore, të cilat janë parakushte vendimtare për të arritur një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional:

1. **Rritja e fondit pyjor, në drejtim të sasisë (volumi mesatar për hektar) dhe cilësisë (lënda drusore e prodhuar në pyjet trungishte).** Ky PMPK duhet të shënojë një pikë kthese dhe një ndarje të qartë nga tendencat e mbishfrytëzimit të së kaluarës. Qëllimi i ndjekur është gjithashtu përmirësimi i prodhimtarisë së pyjeve, si edhe i vlerës së përgjithshme të burimeve pyjore (produkteve drusore, sekuestrimit të karbonit, shtimit të biodiversitetit, mbrojtjes së tokës dhe pjellorisë së saj, përmirësimi i shëndetit dhe vitalitetit të ekosistemit).
2. **Konsiderimi i funksionit mbrojtës ndaj tokës si faktor kryesor që duhet të zbatohet para çdo lloj ndërhyrje në pyje.**
3. **Zbatimi i praktikave të kullotjes në përputhje me nevojën e grumbujve pyjorë për t'u ripërtërirë dhe domosdoshmërinë për të ruajtur një mbulesë vegjetacioni të mjaftueshme.** Kjo nënkupton përjashtimin dhe mbrojtjen e zonave specifike të ndjeshme nga kullotja për një periudhë 5-vjeçare.

Si një kusht përfundimtar për sukses, arritja e këtyre objektivave kërkon domosdoshmërisht një kontroll dhe një bashkërendim më të mirë midis stafit të pyjeve të bashkisë dhe palëve të interesuara lokale. Prandaj do të jetë e një rëndësie shumë të madhe t'i kushtohet vëmendja kryesore që, **procesi i zbatimit do të përfshijë të gjitha palët e interesuara, nga komunitetet lokale dhe shoqatat e përdoruesve (bazuar në të drejtat e tyre të përdorimit) tek drejtuesit e pyjeve të bashkisë dhe përfaqësuesit e bashkisë, duke ndërvepruar ngushtësisht dhe respektuar rolet e ndërsjella.** Kjo qartësisht përfshin një kontroll të rreptë mbi prerjet e paligjshme.



*Shembull i një trungishte Ahu në fazat e reja të moshës në EP Rove, që ilustron nevojën për rritjen e volumit drusor para planifikimit të shfrytëzimit*

## IX.2 Objektivat kombëtare për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave

Sikurse është shtjelluar në seksionet I.2 dhe II.2, ky PMPK u punua duke iu përmbajtur ngushtësisht rregullores dhe kuadrit politik kombëtar për mbarështrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, ndër të cilët: Reforma administrative dhe Ligji Nr. 115/2014; Ligji Nr. 9385/2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2016 “Disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9385, datë 4.5.2005”; Ligji Nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”; Dokumenti i Politikave Pyjore në Shqipëri, 2019-2030 me VKM Nr. 814, datë 31.12.2018.

## IX.3 Përputhshmëria me Planifikimin Bashkiak dhe Rajonal

Ky PMPK u hartua në përputhshmëri të plotë me planet rajonale dhe bashkiake dhe qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional. Në këtë aspekt, plani i kushtoi një vëmendje kryesore përkthimit në mënyrë operationale të interesit dhe pritshmërive të popullsisë lokale.

Ky plan mbarështrimi u zhvillua sipas parimit të transferimit të kompetencave dhe rritjes së ndërgjegjësimit midis aktorëve, pas një sërë takimesh duke nënkuptuar në të gjitha fshatrat dhe me të gjitha palët e interesuara të EP Rove. Prandaj, u mbledh dhe u integrua informacion thelbësor rreth vizionit të banorëve në lidhje me përdorimin e pronës së tyre, dëshirat e tyre për të zhvilluar trashëgiminë dhe mënyrën se si ata do ta administrojnë atë në të ardhmen. **Qëllimi i përgjithshëm ishte përcaktimi i masave dhe ndërhyrjeve, duke ekuilibruar burimet pyjore dhe kullimore me pritshmëritë e komunitetit lokal.** Raporti i procesit të pjesëmarrjes ofron më shumë hollësi rreth metodologjisë dhe rezultateve.

**Në këtë kuadër, mundësitë dhe sfidat e identifikuara gjatë takimeve me palët e interesuara lokale përmbledhen si më poshtë:**

Mundësitë	Sfidat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Agro-turizmi</b> (orientimi i bizneseve lokale, prodhimi i një harte eko-pyjore, përdorimi i tokave djerrë)</li> <li>• <b>Agro-pylltaria</b> (identifikimi i zonave potenciale dhe inkurajimi i zhvillimit të kësaj praktike)</li> <li>• <b>Bimët mjekësore</b> (Kultivimi dhe mbledhja e BM si një mundësi për rritjen e të ardhurave të familjeve rurale)</li> <li>• <b>Pyllëzimet</b> (me specie autoktone me rritje të shpejtë në sipërfaqe me bimësi pyjore, sipërfaqet e shpyllëzuara, të djegura, anës lumenjve, mbjellja e arrave)</li> <li>• <b>Ripërtëritja e pyjeve cunqishte dhe shkurreve</b>(Përmes pyllëzimit, pastrimeve, rrallimeve, etj.)</li> <li>• <b>E drejta e përdorimit bazuar tek tradita</b>(ligji i ri për pyjet pritet të rregullojë me një VKM të drejtën e përdorimit të pyjeve për banorët me qëndrim të përhershëm në fshat)</li> <li>• <b>Mbrojtja e pyjeve nga komunitetet/ Promovimi i praktikave të mira</b>( të mbrojtjes së pyjeve nga vet komunitetet lokale)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Prerje jo të rregullta dhe mbishfrytëzim</b> (mbrojtja e pyjeve pa kufizuar nevojat e banorëve; pyjet e mbetur të pazhvilluar – shkurre – pas mbishfrytëzimit të tyre; mbrojtja veçanërisht e pyjeve brigjeve të liqeneve dhe lumenjve)</li> <li>• <b>Menaxhimi i kullotave</b>(kërkohet një planifikim më i mirë dhe ndërtimi i lerave)</li> <li>• <b>Erozioni</b>(nevojitet ndërtimi i pritave malore dhe veprave të tjera antierozive)</li> <li>• <b>Zjarret</b>(rekomandohet marrja e masave parandaluese ndaj zjarreve dhe ngritja e grupeve të shuarjes së zjarrit)</li> <li>• <b>Njohja dhe sigurimi i të drejtës së përdorimit</b>(në varësi të fshatrave, pyjet zakonisht përdoren në bazë lagje ose familje)</li> <li>• <b>Konçensionet</b>(janë dy konçensione aktive deri në vitin 2023 dhe 2025)</li> <li>• <b>Vëmendja ndaj pyjeve dhe kullotave</b>(pyjet dhe kullotat nuk janë përparësi për pushtetin vendor)</li> <li>• <b>Lëvizjet demografike</b>(migrimi dhe emigrimi i moshave të reja)</li> <li>• <b>Gjenerimi i të ardhurave nga pyjet</b>(pyjet përdoren vetëm për mbijetesë)</li> <li>• <b>Mbështetja financiare</b>(investimet në pyje mungojnë prej vitesh)</li> </ul>

**Pritshmëritë më specifike të popullsisë lokale jepen për fshatrat ku u organizuan takimet. Këto kanë një rëndësi parësore dhe duhet të merren me konsideratë në mënyrë të kujdesshme gjatë periudhës së zbatimit të këtij PMPK, me një qëllim të qartë për përmirësimin e bashkërendimit dhe ndërveprimeve midis të gjitha palëve të interesuara.**

Fshati	Problemet	Mundësitë	Rekomandimet për PMPK
<b>Kukur</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prerjet pa kriter.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjendja e pyjeve është përmirësuar.</li> <li>Kullotat.</li> <li>Bimët mjekësore (aguliçe, salep, shtog, trëndafil i egër, lisa, etj.).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbrojtja e pyjeve nga zjarret.</li> <li>Kryerja e rrallimeve dhe pastrimeve.</li> <li>Ndërtimi i lerave për bagëtitë.</li> </ul>
<b>Gribë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sipërfaqe pyjore e kufizuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kullotat.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi i lerave për bagëtitë.</li> </ul>
<b>Kalaj</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sipërfaqe pyjore e kufizuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Banorët janë të interesuar për zhvillimin e pyjeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pyllëzime me arrorë (lajthi).</li> </ul>
<b>Irmath</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sipërfaqe pyjore e kufizuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Banorët janë të interesuar për zhvillimin e pyjeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pyllëzime të reja për rritjen e sipërfaqes pyjore.</li> </ul>
<b>Vreshtas</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sipërfaqe pyjore e kufizuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Banorët janë të interesuar për zhvillimin e pyjeve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pyllëzime të reja për rritjen e sipërfaqes pyjore.</li> </ul>



*Foto ilustruese e një takimi në qytetin e Gramshit në kuadër të procesit pjesëmarrës*

#### IX.4 Objektivat kryesore të PMPK

Qëllimi kryesor i këtij PMPK është të sigurojë një mbarështrim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve dhe kullotave të Ekonomisë Pyjore Rove, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe

ekologjike, duke promovuar bashkërendimin e ngushtë ndërmjet stafit të pyjeve, popullsisë lokale dhe përfaqësuesve lokalë. Kjo përfundimisht do të lejojë **optimizimin e përfitimeve socio-ekonomike të burimeve për palët e interesuara lokale sot dhe në të ardhmen.**

Në përputhje të plotë me objektivat e përgjithshme të përmendura në pjesën IX.1, qëllimet kryesore janë:

- Arritja e qëndrueshmërisë dhe shumëfunktionalitetit të pyjeve dhe kullotave në mënyrë që të përmirësohet cilësia e lëndës drusore të prodhuar, të mirëmbahet mbrojtja ndaj erozionit dhe rreziqeve natyrore, të ruhet biodiversiteti, të sigurohen të ardhura dhe burime sipas nevojave lokale, tëmbahet ekosistemi vital dhe në gjendje të mirë shëndetësore.
- Përmirësimi i rritjes natyrore të grumbujve pyjorë përmes ndërhyrjeve silvikulturore, duke synuar njëkohësisht balancim më të mirë midis klasave të moshës dhe rritje të kapitalit drusor dhe sekuestrimit të karbonit.
- Lejimi i ripërtëritjes së pyjeve me praktika të përshtatura të kullotjes.
- Rimëkëmbja e mbulesës së degraduar të vegjetacionit nëpërmjet pyllëzimeve.
- Mirëmbajtja dhe përmirësimi i funksionalitetit të rrjetit rrugor.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe ndërtimi i kapaciteteve të banorëve për ndërhyrje të përshtatshme në pyje në përputhje me nevojat e tyre.
- Zbatimi i masave aktuale nëpërmjet veprimeve interaktive dhe të bashkërenduara që lidhen me palët e interesuara lokale dhe zhvillojnë ndjenjën e përgjegjshmërisë dhe kontrollit ndaj mbikullotjes dhe prerjeve të paligjshme.

## IX.5 Objektivat specifike për ekonominë pyjore

Objektivi kryesor i kësaj detyre ishte hartimi i planit të mbarështrimit për ekonominë pyjore Rove, si pjesë e territorit të bashkisë Gramsh.

Njohja e situatës reale të grumbujve pyjorë dhe planifikimi i masave për të siguruar vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre konsiderohet si një tjetër detyrë. Në kuadër të përgatitjes së planit të mbarështrimit, përparësitë e planifikimit u harmonizuan dhe u ndërthurën me ato të prodhimit të lëndës drusore dhe krijimit të rezervave të larmishme të biodiversitetit dhe rimëkëmbjes së sipërfaqeve të degraduara në mënyrë sa më natyrale.

Ky plan do të sigurojë një ekuilibër midis vlerave natyrore – si biodiversiteti – dhe aspekteve ekonomike në mënyrë që të plotësojë nevojat e komuniteteve dhe të përmirësojë jetesën e tyre. Procesi pjesëmarrës dhe të drejtat gjinore kanë qenë shtyllat kryesore gjatë hartimit të këtij PMPK.

### IX.5.1 Objektivat specifike për përdorimin e tokës, funksionin dhe regjimin qeverisës

Lidhur me përdorimin e tokës ne parashikojmë që në periudhën 10 vjeçare të zbatimit të këtij PMPK, sipërfaqet me bimësi pyjore, të cilat janë degraduar nga shfrytëzimet e paligjshme dhe prerjet për dru zjarri, të kthehen sërish në sipërfaqe pyjore nëpërmjet aktiviteteve të ripyllëzimit. Sipërfaqja me

bimësi pyjore e disponueshme për mbjellje është 36.8 ha dhe speciet e propozuara për mbjellje janë Ahu dhe Rrobulli. Gjithashtu propozojmë të ripyllëzohen disa parcela pyjore që tashmë janë të djegura. Vlerësimet tona tregojnë që sipërfaqja pyjore e djegur dhe e disponueshme për mbjellje është 37 ha. Kështu, sipërfaqja e përgjithshme e propozuar për rimëkëmbje përmes ripyllëzimit është rreth 73.8 ha.


Parcela pyjore	N/ekonomia pyjore	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja e disponueshme për mbjellje (ha)	Ndërhyrja
8c	Rove 1	13	10	Ripyllëzim
10b	Rove 1	19.7	4.6	Ripyllëzim
15a	Rove 1	5.1	5.1	Ripyllëzim
14c	Rove 2	1.6	1.6	Ripyllëzim
17c	Rove 2	7.7	7.7	Ripyllëzim
33c	Rove 2	7.8	7.8	Ripyllëzim
<b>Gjithsej</b>		<b>54.9</b>	<b>36.8</b>	

Parcela pyjore	N/ekonomia pyjore	Sipërfaqja (ha)	Shkaku i dëmtimit	Niveli i dëmtimit	Ndërhyrja
28a	Rove 2	7.4	Zjarri	Mesatar	Ripyllëzim
10a	Rove 3	10.3	Zjarri	Mesatar	Ripyllëzim
1b	Rove 4	19.3	Zjarri	I rëndë	Ripyllëzim
<b>Gjithsej</b>		<b>37</b>			

#### IX.5.2 Objektivat specifike për tipet pyjore

Objektivi specifik lidhur me tipet pyjore është ruajtja e përbërjes ekzistuese të specieve dhe përmes ndërhyrjeve të përmirësohet gjendja e grumbujve pyjorë. Gjithashtu, gjatë ripyllëzimeve ne synojmë të përdoren specie pyjore që rriten në gjendje natyrore (të zonës), të tilla si Pisha e Zezë dhe Ahu, Rrobulli, etj. Kështu që, në parcelat pyjore të paraqitura mësipër synojmë të krijojmë grumbuj pyjorë me anë të ripërtëritjes artificiale dhe speciet e propozuara do të jenë ato që rriten në gjendje natyrore.

Një objektivi tjetër do të jetë zëvendësimi i grumbujve pyjorë të vjetër në moshë me grumbuj pyjorë të rinj dhe instalimi i filizërisë në parcelat pyjore që do të shfrytëzohen. Kështu, në rastin e trungishteve, grumbujt pyjorë që kanë moshë mbi 80 vjeçare do të shfrytëzohen gjatë periudhës 10 vjeçare të vlefshmërisë së PMPK. Ata do të zëvendësohen nga grumbujt me moshë të re nëpërmjet ripërtëritjes natyrore. Sipërfaqja e përgjithshme që do të nënshtrohet prerjeve përfundimtare është 109.3 ha dhe volumi i përgjithshëm në këmbë i përfutur është 30377 m<sup>3</sup>.



### IX.5.3 Objektivat specifike silvikulturore



*Grumbull pyjor i Pishës së zezë në EP Rove pranë plotësimit të kriterëve të planifikimit të rrallimeve (majtas) dhe prerjes së shfrytëzimit (djathtas)*

Në lidhje me objektivat silvikulturore për EP Rove, synimi ynështetë të shtojmë sipërfaqen pyjore përmes rimëkëmbjes së tokave pyjore të degraduara dhe aplikimi i ndërhyrjeve silvikulturore, si rrallimet, prerjet e njepasneshme uniforme, etj. Sipërfaqja e përgjithshme e përcaktuar për aplikimin e ndërhyrjeve

silvikulturore është 730.5 ha, ndërsa sipërfaqja që do i nënshtrohet prerjeve njepasnëshme uniforme është 156.64 ha.

Bazuar nëmatjet e terrenit kemi përcaktuar parcelat pyjore dhe sipërfaqet se ku do të aplikohen këto ndërhyrje. Në tabelat më poshtë jepen parcelat pyjore, sipërfaqet përkatëse, llojet e ndërhyrjeve dhe viti i zbatimit.

Parcela	Sip (ha)	Speciet	Klasa moshës	Kurordendësia	Diam. Mesatar(cm)	Lartësia mesatare (m)	Nr.drurëve për ha	Sip bazimetrike (m <sup>2</sup> /ha)	Volumi (m <sup>3</sup> /ha)	Volumi total (m <sup>3</sup> )	Ndërhyrja
10c	12.3	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	5.3	5	3600	10.2	57.2	703.5	Rr. tipit të I-rë
13a	50.0	AH	41-60	E lartë (0.9-1.0)	10.7	7.1	4713	49.1	379.8	18976.3	Rr. tipit të II-të
18e	1.2	AH	41-60	E lartë (0.9-1.0)	10.5	8.5	6900	26.9	172.3	206.8	Rr. tipit të II-të
19a	38.2	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	6.5	7	8215	25.1	154.5	5901.9	Rr. tipit të I-rë
19b	25.8	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	5.8	7	6875	18	103.6	2672.9	Rr. tipit të I-rë
20d	6.5	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	7.1	8.5	6175	25.1	158.4	1033.4	Rr. tipit të I-rë
21d	17.0	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	6.2	5.8	6900	21.1	123	2094.1	Rr. tipit të I-rë
22a	16.2	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	8.5	11.3	5727	32.7	214.7	3483.3	Rr. tipit të I-rë
22b	9.9	AH	41-60	E lartë (0.9-1.0)	11	10.5	5300	49.6	359.6	3560.0	Rr. tipit të II-të
22e	16.8	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	8.2	9	6470	34.7	221.8	3736.1	Rr. tipit të I-rë
23a	31.9	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	8	11.6	10219	48.1	303.2	9664.6	Rr. tipit të I-rë
24a	8.3	AH	0-20	E lartë (0.9-1.0)	5	5	3775	8.1	42.9	356.4	Rr. tipit të I-rë
25a	54.0	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	10	8	6947	53.5	360.5	19466.2	Rr. tipit të I-rë
26a	15.9	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	9.1	7	8000	52.1	349.1	5553.6	Rr. tipit të I-rë
26b	3.7	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	11.4	8	600	6.2	40.8	150.2	Pastrime ne Bredh
26c	16.6	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	10.7	8	4219	38.1	235.7	3914.4	Rr. tipit të I-rë
26d	7.9	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	8.6	6.5	5225	30.1	195.4	1543.7	Rr. tipit të I-rë
26e	9.3	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	9	6.5	9600	58.77	365.5	3417.0	Rr. tipit të I-rë
27a	34.4	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	7.5	6.1	10713	47.8	291.85	10047.8	Rr. tipit të I-rë
27b	10.6	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	8	12.2	5925	30.2	124.4	1323.9	Rr. tipit të I-rë
28a	25.6	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	7.3	11	9560	40	243.4	6224.3	Rr. tipit të I-rë
28c	0.6	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	9.1	10	4100	27	181.7	106.9	Rr. tipit të I-rë
28d	1.9	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	9	10	6375	23.4	198	376.2	Rr. tipit të I-rë
31a	22.7	AH	0-20	E lartë (0.9-1.0)	5.5	7	8275	19.8	105.4	2392.6	Rr. tipit të I-rë
32a	37.8	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	12	11	4200	46.7	359.7	13596.7	Rr. tipit të I-rë
32b	3.5	AH	0-20	E lartë (0.9-1.0)	4.5	6.5	6475	10.4	48.7	170.5	Rr. tipit të I-rë

<b>36b</b>	7.6	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	7.8	9.1	5825	28	185.1	1406.8	Rr. tipit të l-rë
<b>39a</b>	19.1	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	8.2	11	5780	30.6	205.6	3927.0	Rr. tipit të l-rë
<b>39c</b>	15.6	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	9	11.5	5066	30.8	141.3	2199.8	Rr. tipit të l-rë
<b>40c</b>	14.1	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	8.7	12.5	5680	33.7	221.7	3116.7	Rr. tipit të l-rë
<b>41b</b>	8.4	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	7.8	10.5	5450	25.9	171.8	1443.1	Rr. tipit të l-rë
<b>18b</b>	18.5	AH	0-20	E lartë (0.9-1.0)	5	7.5	5100	10.4	58.9	1089.7	Rr. tipit të l-rë
<b>10a</b>	25.8	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	7.5	10	4837	21.6	129	3328.2	Rr. tipit të l-rë
<b>29a</b>	26.5	AH	0-20	E lartë (0.9-1.0)	5.1	6	5875	12.1	62.5	1658.6	Rr. tipit të l-rë
<b>28a</b>	24.8	AH	0-20	E lartë (0.9-1.0)	7	6.5	4975	19.3	113.5	2812.2	Rr. tipit të l-rë
<b>28b</b>	6.1	AH	21-40	E lartë (0.9-1.0)	9.1	10.9	5037	33.1	213.6	1303.0	Rr. tipit të l-rë
<b>Gjithsej</b>	<b>730.5</b>										

Parcela	Sipërfaqja (ha)	Klasa e moshës	Ndërhyrja	Viti i ndërhyrjes										
				2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	
12a	<b>4.20</b>	101-120	Prerje njepasnjeshme uniforme	<b>30%</b>				<b>30%</b>					<b>40%</b>	
24b	<b>1.40</b>	81-100	Prerje njepasnjeshme uniforme			<b>30%</b>			<b>30%</b>					<b>40%</b>
25a	<b>8.68</b>	81-100	Prerje njepasnjeshme uniforme				<b>30%</b>			<b>30%</b>				<b>40%</b>
37a	<b>1.51</b>	81-100	Prerje njepasnjeshme uniforme				<b>30%</b>			<b>30%</b>				<b>40%</b>
16b	<b>1.32</b>	101-120	Prerje njepasnjeshme uniforme		<b>30%</b>			<b>30%</b>				<b>40%</b>		
11b	<b>22.10</b>	81-100	Prerje njepasnjeshme uniforme											
12a	<b>34.10</b>	81-100	Prerje njepasnjeshme uniforme			<b>30%</b>			<b>30%</b>				<b>40%</b>	
	<b>7.90</b>	81-100	Prerje njepasnjeshme uniforme				<b>30%</b>			<b>30%</b>				<b>40%</b>
14a	<b>17.80</b>	81-100	Prerje njepasnjeshme uniforme		<b>30%</b>				<b>30%</b>				<b>40%</b>	
19a	<b>38.13</b>	81-100	Prerje njepasnjeshme uniforme					<b>30%</b>				<b>30%</b>		<b>40%</b>
	<b>156.64</b>													

Sipërfaqja e përgjithshme e disponueshme për ripyllëzime në EP Rove është 382.9 ha dhe ne propozojmë të ripyllëzohen të gjithat tokat me bimësi pyjore, duke përdorur lloje autoktone që rriten në gjendje natyrore në secilën parcelë.

#### IX.5.4 Objektivat specifike për kullotat

Sipërfaqja e kullotave në EP Rove është 259.03 ha. Ne propozojmë disa masa për përmirësimin e gjendjes së kullotave dhe prodhimtarinë e tyre. Prandaj, në mënyrë që të rritet prodhimtaria e tyre propozojmë disa masa, të tilla si: pastrimi i gurëve dhe rritja e mbulesës barishtore nëpërmjet barëzimit me farë. Kapaciteti mbajtës i kafshëve varion nga njëra parcelë tek tjetra dhe me masat e propozuara, ky kapacitet pritet të jetë më i lartë. Disa nga ndërhyrjet e propozuara për përmirësimin e gjendjes së kullotave dhe parcelat përkatëse paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Parcela pyjore	Sipërfaqja (ha)	Njësia ekonomike	Përmbajtja e gurëve (%)	Ndërhyrja e propozuar
19c	31.4	Rove 1	E lartë > 60%	Pastrim gurësh
1c	30.4	Rove 2	E lartë > 60%	Pastrim gurësh
18b	6	Rove 2	E lartë > 60%	Pastrim gurësh
2c	11.2	Rove 2	E lartë > 60%	Pastrim gurësh
22d	5	Rove 1	E lartë > 60%	Pastrim gurësh
6b	14.9	Rove 2	E lartë > 60%	Pastrim gurësh
17b	8.5	Rove 2	E lartë > 60%	Pastrim gurësh
<b>Gjithsej</b>	<b>107.4</b>			

Parcela pyjore	Sipërfaqja (ha)	Njësia ekonomike	Shkalla e mbulimit me bar (%)	Ndërhyrja e propozuar
19c	7.05	Rove 2	0.15	Barëzim me farë
<b>Gjithsej</b>	<b>7.05</b>			

Zbatimi i praktikave të kullotjes në përputhje me nevojën e grumbujve pyjorë për t'u ripërtëritur dhe domosdoshmërinë për të ruajtur një mbulesë vegjetacioni të mjaftueshme çon në strategjinë e mëposhtme:

Tipi i përdorimit	Objektivat e mbarështrimit	Llojet e aktiviteteve	Masat pardehuese dhe mbrojtëse
<b>Kullotë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbrojtja mjedisore.</li> <li>- Ruajtja e zonave të ndjeshme specifike.</li> <li>- Mirëmbajtja e kapacitetit kullosor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Punime përmirësuese të kullotave: ndërtim lerash, pastrim gurësh.</li> <li>- Mbjellja e drurëve foragjerë në formë brezash përreth fshatrave.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizimi i kullotjes racionale midis përdoruesve</li> <li>- Përfshirja e zonave më të ndjeshme (tokat e eroduara, sip. që kanë nevojë për ripërtëritje) nga kullotja për 5 vjet</li> <li>- Lidhja e kontratave me përdoruesit.</li> </ul>



*Ripërtëritja e Bredhit të bardhë (majtas) dhe cungishte Qarri (djathtas) në EP Rove për t'u ruajtur nga kullotja*

#### **IX.5.5 Objektivat specifike për biodiversitetin**

**Ruajtja e biodiversitetit aktual dhe përmirësimi i gjendjes së habitateve dhe biotopeve janë objektivat kryesore të këtij plani mbarështrimit.** Mbarështrimi i pyjeve dhe teknikat silvikulurore do i kushtojnë një vëmendje të veçantë arritjes së objektivave të mëposhtme:

- Ruajtjes së ligatinave dhe funksionalitetit të tyre;
- Mbrojtjes, sa më shumë të jetë e mundur, së specieve pionere gjatë shfrytëzimit;
- Ruajtjes së një rrjeti drurësh me vlera të larta biologjike (drurë të tharë, të moçëm, me zgavra...). Disa individë me diametër të madh nuk do të shfrytëzohen për të përmirësuar zhvillimin e dendro-mikro-habitatave specifikisht lidhur me drurët e tharë;
- Mbrojtjes së drurëve të tharë e të rrëzuar dhe disa cungjeve të lartë për zhvillimin e myshqeve saprofitë të drurit;
- Promovimit, sa më shumë të jetë e mundur, të grumbujve pyjorë të përzier dhe ripërtëritjes natyrore të specieve të adaptuara;
- Evolucionit natyral të çeltrave midis grumbujve (më pak se 0.5 ha) të ripërtërira nga shqetësimet e rreziqeve;
- Ruajtjes së skajeve të pyjeve;
- Afatevetë ndërhyrjeve duke shmangur periudhat kritike për ciklet jetësore të specieve të rralla ose të mbrojtura.

#### **IX.5.6 Objektivat specifike për gjendjen shëndetësore**

Një objektiv tjetër i rëndësishëm është përmirësimi i gjendjes shëndetësore të burimeve pyjore. Gjatë punës së terrenit vërejtëm shumë sipërfaqe të dëmtuara nga prerjet e paligjshme, prerjet e druve të zjarrit, insektet dhe sëmundjet. Në mënyrë që të shmangen këto dëmtime propozojmë ndërhyrjet e mëposhtme:

- Rimëkëmbja e sipërfaqeve të degraduara nga prerjet e paligjshme dhe të druve të zjarrit;

- Inspektimi i shpeshtë i zonës nga stafi i pyjeve të Bashkisë;
- Përgatitja e një plani të hollësishëm me masat e duhura për luftën ndaj zjarreve;
- Identifikimi i zonave të prekura nga procesionarja apo ndonjë insekt tjetër dhe aplikimi i luftimit mekanik ose biologjik.

**Një vëmendje e veçantë do i kushtohet vëzhgimit të efekteve nga thatësitat e përsëritura në kontekstin e ndryshimeve klimatike në vazhdim.** Kështu, një monitorim specifik i shëndetit të grumbujve do të jetë i domosdoshëm përgjatë kohëzgjatjes së këtij PMPK.

Grumbujt artificialë nga mbjelljet e mëhershme nuk paraqesin ndonjë rrezik potencial nga insektet apo sëmundjet, pasi ata janë në arealin e tyre. Drurët e rrëzuar nga shkaqe natyrore (rrëzimet për shkak të moshës, erës, borës, akullit dhe faktorëve të tjerë atmosferikë) do të mbeten në gjendjen e tyre natyrale, duke i lënë në procesin e dekompozimit natyral.

#### IX.5.7 Objektivat specifike për faunën e egër

Fauna e egër është një përbërës i rëndësishëm i biodiversitetit të EP Rove. Duke qënë se tashmë është në fuqi moratoriumi i gujetisë, mbrojtja e faunës së egër do të jetë më e lehtë dhe më e mirë përgjatë kohëzgjatjes së këtij plani mbarështrimi.

#### IX.5.8 Objektivat specifike për pyjet me funksion prodhues

Shumica e grumbujve pyjorë në EP Rove 1 dhe 2 kanë funksion prodhues. Ata përdoren për prodhimin e lëndës drusore dhe prodhimet jodrusore siç janë frutat e pyllit. Disa nga parcelat e identifikuar për prodhimet jodrusore jepen në tabelën e mëposhtme:

Parcela pyjore	Njësia ekonomike	Sipërfaqja (ha)	Funksioni kryesor	Funksioni specifik	Përshkrimi
10c	Rove 1	9.8	Prodhues	Jodrusor	Fruta
16c	Rove 1	15.1	Prodhues	Jodrusor	Fruta
17c	Rove 2	7.7	Prodhues	Jodrusor	Fruta
33c	Rove 2	7.8	Prodhues	Jodrusor	Fruta
10b	Rove 1	19.7	Prodhues	Jodrusor	Fruta
<b>Gjithsej</b>		<b>60.1</b>			

#### IX.5.9 Objektivat specifike për pyjet me funksion mbrojtës

Parcelat pyjore me funksion mbrojtëskanësi funksion specifik stabilizimin e tokës. Zakonisht, të gjitha parcelat pyjore në shpatet e pjerrëta përreth zonave të banuara konsiderohen me funksion mbrojtës. Sipërfaqja e eroduar, vlerësuar nga ekipi i terrenit është 72 ha dhe parcelat pyjore me shenja erozioni paraqiten më poshtë:

Parcela pyjore	Sip. (ha)	Njësia ekonomike	Mbulesa e tokës	Funksioni kryesor	Funksioni specifik	Masa e propozuar
13a	40	Rove 1	Pyll	Mbrojtës	Tokes	Prita malore/ripyllëzim
19d	9.21	Rove 1	Tokë me bimësi pyjore	Mbrojtës	Tokes	Prita malore/ripyllëzim
8c	13	Rove 1	Tokë me bimësi pyjore	Mbrojtës	Tokes	Prita malore/ripyllëzim
7d	9.8	Rove 1	Pyll	Mbrojtës	Tokes	Prita malore/ripyllëzim
<b>Gjithsej</b>	<b>72.01</b>					

Në mënyrë që të parandalohet erozioni i tokës, ne kemi identifikuar zonat e ndërhyrjes dhe masat e duhura, duke përfshirë masa inxhinierike dhe biologjike. Ne propozojmë ndërtimin e pritave malore /ose gardheve të gjelbër për parandalimin e erozionit dhe ripyllëzimin e zonës.

#### IX.5.10 Objektivat specifike për pyjet me funksion rekreativ

Pavarësisht mungesës së infrastrukturës, është e njohur që EP Rove me peizazhet dhe ekosistemet e saj spektakolare ka një potencial për të ofruar aktivitete rekreative dhe turistike dhe për të zhvilluar ekoturizmin midis banorëve. Kjo do të siguronte të ardhura shtesë për ekonominë pyjore dhe në të njëjtën kohëpërfaqëson një burim punësimi për popullsinë lokale.

#### IX.5.11 Objektivat specifike për pyjet me status mbrojtës

Bazuar në sipërfaqet e inventarizuara, të cilat kanë nxjerrë në pah disa specie të rralla ose të mbrojtura, duhet të kryhen studime të mëtejshme për të përcaktuar vlerën e saktë të biotopit dhe habitatit shoqërues. Kjo mund të çojë në propozimin e bio-monumenteve ose siteve të mbrojtura të reja për t'u regjistruar dhe administruar nga Agjencia Kombëtare Mjedisore.

Për më tepër, disa nga grumbujt e jashtëzakonshëm dhe të rrallë të Bredhit të bardhë në n/parcelat 18c, 20c, 24a dhe b, 25a, 26b dhe c, 27b, 28c, 29a dhe c, 42 duhet të përfitojnë statusin e mbrojtjes. Gjithashtu, genotipi i tyre duhet të analizohet për një klasifikim të mundshëm si një rezervat gjenetik.

## X. Masat e planifikimit / aktivitetet në kuadër të PMPK

### X.1 Mundësia vjetore e shfrytëzimit

#### Metoda 1. Kombinimi i volumit dhe rritjes së pyjeve

